



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 MARS 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13. MARTA 2019. GODINE**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava u vezi sa blokiranjem Centralne izborne komisije od strane Predsednika

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Koha është të fillojmë seancën.

Përfaqësuesit e Qeverisë nuk kanë ardhur.

Unë i hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesën e 44 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ka qenë e caktuar për datën 6 mars 2019, me kërkesë të propozuesit, shtyrë për datën 13 mars 2019.

44 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti.

Kush do ta paraqesë ekspozenë, zoti Sami Kurteshi e ka fjalën në emër të propozuesit që të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

SAMI KURTESHI: Faleminderit për fjalën e dhënë, zoti kryesues!

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne 44 deputetë më 28 shkurt 2019 kemi bërë kërkesë për seancë të jashtëzakonshme në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 139, e definojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si organ të përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, referendumeve dhe shpall rezultatet e tyre.

KQZ-ja përbëhet nga 11 anëtarë, në pajtim me Kushtetutën.

Në bazë të Ligjit për zgjedhje, neni 61.4, thotë: “Mandati i anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fillon jo më vonë se 60 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës”.

Rezultati i zgjedhjeve të përgjithshme për legjislaturën aktuale është certifikuar më 8 korrik 2017. Sipas kësaj, përbërja e KQZ-së do të duhej të ndryshonte më së largu deri më 5 shtator 2017, duke reflektuar rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme të përgjithshme të 11 qershorit.

Nga data 5 shkurt 2017, KQZ-ja do të duhej të kishte përbërje të re që do të reflektonte rezultatin e zgjedhjeve të 11 qershorit.

Mirëpo, nga data 27 mars 2018 KQZ është bllokuar. Nga 27 marsi i vitit 2018, KQZ si një institucion i pavarur dhe i përhershëm nuk funksionon.

Presidenti i Republikës së Kosovës më së voni deri më 27 mars 2018 ka qenë i detyruar të konfirmojë nominimet e subjekteve politike për anëtarët e KQZ-së në përputhje me përgjegjësitë e obligimit të tij kushtetuese dhe ligjore për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë.

Presidenti, sipas detyrimit ligjor, është dashur që më së voni deri më 28 mars 2018 ta përmbyllë procesin e emërimit të anëtarëve të KQZ-së dhe të mos mbajë peng konstituimin dhe funksionimin e KQZ-së. Megjithëkëtë, KQZ-së vazhdon të mbetet i bllokuar dhe jofunksional.

Presidenti kishte arsyetuar mosemërimin e anëtarëve të KQZ-së në bazë të nenit 61.3 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, paragrafi e, i cili thotë: “Pavarësisht nga pika d e këtij paragrafi mandati që përfundon 90 ditë ose më pak para zgjedhjeve ose deri 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve automatikisht zgjatet për 90 ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore”.

Nisur nga fakti se tash ishin shpallur zgjedhjet lokale me interpretimin se anëtarëve aktualë u zgjatet mandati deri 90 ditë pas certifikimit të zgjedhjeve lokale.

Meqë Presidenti nuk e kishte iniciuar procedurën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu siç parashikohet me Kushtetutë dhe Ligjin për zgjedhjet më 17 prill 2018 kishin dorëzuar nominimet e tyre të anëtarë të KQZ-së.

Presidenti kishte kërkuar dokumentacion shtesë për përshtatshmërinë e kandidatëve dhe pasi që dy subjektet opozitare kishin dorëzuar ato, Presidenti pa kurrfarë arsytimi e shpjegimi, as publik as te subjektet politike, kishte pezulluar procedurën e nominimit.

Krejtësisht në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin për zgjedhjet, më 7 qershor 2018 Presidenti kishte parashtruar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me përbërjen e KQZ-së.

Më 3 dhjetor 2018 Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur papranueshmërinë e kërkesës së Presidentit.

Edhe pse procedura e emërimit të anëtarëve të KQZ-së ishte ndërprerë, por nuk ishte përmbyllur më 14 dhjetor 2018, Zyra e Presidentit, përkatësisht drejtori i Departamentit për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nëpërmjet një emali drejtuar kryesuesve të grupeve parlamentare në Kuvend njofton mundësinë, siç e kanë quajtur, përbërjen e nominimeve për

anëtarë të KQZ-së, duke bërë përpjekje për të kontrabanduar një përbërje antikushtetuese të KQZ-së.

Këtij vendimi, në thelb kundërkushtetues të Zyrës së Presidentit, për të ndryshuar përbërjen e KQZ-së në tavolinë, duke shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, por edhe vullnetin e votuesve, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës janë përgjigjur me dorëzimin e nga dy nominimeve, ashtu siç parashihet edhe me dispozita të Kushtetutës, të Ligjit për zgjedhje të përgjithshme, kur flitet për përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe procedurën që parasheh ligji dhe sipas kuptimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KOU9/14 të datës 26 gusht 2014 për grupet parlamentare.

Përkundër afateve të përcaktuara me Ligjin për zgjedhje, ku shprehimisht parashihet se Presidenti i Kosovës brenda pesë ditëve e konfirmon me shkrim emërimin, emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në emërimin zyrtar nga presidenti i Kosovës.

Me gjithë detyrimin ligjor dhe kushtetues, Presidenti ka vendosur ta pushojë heshtazi procedurën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së dhe sot janë bërë mbi 80 apo 90 ditë që kur subjektet politike parlamentare kanë dorëzuar për herë të dytë nominimet e tyre dhe presidenti nuk i ka konfirmuar.

Si pasojë janë mbi 37 asamblistë që presin më shumë se një vit për nominimin në funksionet e tyre, shumë kuvende komunale janë dëmtuar nga moscertifikimi i tyre, e po ashtu edhe një deputet i Kuvendit të Kosovës ende nuk është nominuar.

Me këtë veprim kundërkushtetues dhe kundërligjor, përveç shkeljes së Kushtetutës dhe ligjit, është dëmtuar drejtpërdrejt dhe vullneti politik i qytetarëve, popullit, si dhe i tërë procesi demokratik.

Po ashtu, me këto veprime janë pamundësuar shumë projekte dhe aktivitete të KQZ-së, janë bllokuar e kanë dështuar shumë iniciativa të mbështetura nga organizata ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve vepruese të KQZ-së si dhe janë bllokuar shumë detyrime të tjera ligjore që janë në kompetencë të KQZ-së pikërisht nga ky bllokim i KQZ-së nga Presidenti.

Sipas informatave brenda KQZ-së, në fund të këtij muaji pushon edhe mandati i kryeshefit ekzekutiv të KQZ-së. Me këtë rast, përveç bllokimit politik, KQZ-së bllokohet edhe në aspektin funksional, administrativ e teknik.

Diçka për sigurinë juridike.

Natyrisht, sikurse çdo ligj dhe normë tjetër ligjore, edhe këto ligje tona, bashkë me Kushtetutën, nuk janë perfektë, këtë e kemi thënë shumë herë.

Prandaj, edhe ekziston e drejta dhe detyrimi për nisma të ndryshme të rregullta ligjore për plotësim dhe ndryshime. Mirëpo, as nuk është detyrim, as e drejtë ligjore, as morale, as s'është kompetencë profesionale e politike dhe as s'është tagër personal i Presidentit si funksion të krijojë anarki dhe paligjshmëri në vend, kjo domethënë të krijojë pasiguri juridike.

Siguria juridike është një ndër vlerat fundamentale të ligjit, si vlerë supreme e fushës juridike, drejtësia është synimi themelor i çdo ligji. Mirëpo, kjo nuk përbën qëllimin përfundimtar të normës ligjore.

Sepse qëllimi parësor, në të vërtetë, është krijimi i paqes shoqërore përmes krijimit të një rendi të besueshëm dhe të qëndrueshëm shoqëror.

Dhe domosdoshmëria e arritjes së një gjendje të sigurisë që krijon një rend të besueshëm dhe të qëndrueshëm shoqëror bëhet edhe më e qartë kur kemi parasysh mungesën e një koncepti universal të drejtësisë.

Koncepti i sigurisë është një koncept funksional, siguria si koncept nuk ka ndonjë kuptim vetvetiu, por vetëm në relacion me konceptet e tjera që japin kuptim.

Vlera e sigurisë nuk është vlerë në vetvete dhe prandaj nuk mund të jetë qëllim, por është një mjet dhe si i tillë ka një vlerë instrumentale në relacion me qëllimin.

Pra, siguria shihet gjithmonë në raport me atë që e siguron dhe vlera e sigurisë rritet në relacion me vlerën që ajo e siguron. Sa më e madhe vlera po rëndësia e objektit apo çështjes së siguruar, aq më e madhe vlera e sigurisë, e në rastin tonë konkret, kemi të bëjmë me sigurinë juridike, e cila sido që ta merrni, përbën thelbin e sigurisë shoqërore. Ne jemi shoqëri e organizuar vetëm kur kemi siguri ligjore.

Pra, pa bërë përpjekje për t'i arsyetuar ligjet e këqija dhe sidomos ato që janë imponim i diktaturave dhe klaneve mafioze, anarkia e krijuar nga një demokrat "i devotshëm", autoritar, ku sundon vetëm ligji i të fortit dhe ku ligji ndryshohet sipas veseve e shijes së të fortit apo grupit të tij, është më e rrezikshme se edhe ligjshmëria e keqe, ku megjithatë ligji është mbi të gjithë dhe mund të ndryshohet me votën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja edhe dy minuta, le ta kryejë ekspozenë.

SAMI KURTESHI: ...dhe ky është thelbi i sigurisë juridike.

Për këto arsye, si dhe arsye të tjera që mund të dalin nga diskutimi parlamentar në këtë seancë të jashtëzakonshme, deputetët nënshkruar në fund të diskutimit i propozojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim këtë rezolutë me një pikë të vetme:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që dekretimi i anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të bëhet pa asnjë vonesë, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese numër DOU9/14 të datës 26 gusht 2014.

Prandaj, të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,
Ju ftoj që në fund të kësaj seance të jashtëzakonshme të votoni këtë rezolutë me kërkesën e vetme që do të mundësonte funksionalizimin e KQZ-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë tani me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, zoti Avdullah Hoti, në emër të Grupit Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Të nderuar qytetarë,

Ne jemi detyruar të ftojmë këtë seancë të jashtëzakonshme, pasi Presidenti, duke mos emëruar anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tash e një vit, nuk po i kryen obligimet e tij kushtetuese.

Që nga data 27 mars 2018, KQZ-ja, që është institucion kyç për funksionimin e demokracisë parlamentare në Kosovë, është jofunksionale.

Procedura që duhet të ndiqet për emërimin e anëtarëve të KQZ-së është plotësisht e qartë. Neni 139 i Kushtetutës thekson se 6 anëtarë të KQZ-së emërohen nga grupet parlamentare që përfaqësojnë komunitetin shumicë në Kuvendin e Kosovës.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 26 gusht 2014 e ka sqaruar se çfarë është grupi parlamentar.

Bazuar në zgjedhjet e 11 qershorit 2017, grupe parlamentare që përfaqësojnë komunitetin shumicë janë Koalicioni PAN, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës.

Këtyre grupeve parlamentare u takojnë nga 2 anëtarë të KQZ-së. Pra, gjithçka ka qenë e qartë, përveç për Presidentin.

Por, si kanë rrjedhur ngjarjet lidhur me këtë çështje?

Nga 5 shtatori 2017 KQZ-ja do të duhej të kishte përbërje të re, e cila do të duhej të reflektonte rezultatin e zgjedhjeve të 11 qershorit 2017. Por, Presidenti vendosi të zgjasë mandatin e përbërjes së mëparshme të KQZ-së edhe për gjashtë muaj, deri më datë 27 mars 2018.

Grupi ynë parlamentar, siç parashikohet me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, në prill të vitit 2018 i ka dorëzuar nominimet për anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas kësaj, Presidenti pezullon procedurën e nominimit, duke parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, i Kushtetutës në lidhje me përbërjen e KQZ-së.

Është evidente se, duke qenë në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, i datës 26 gusht 2018, ku sqarohet se çfarë është grupi parlamentar, kjo kërkesë e Presidentit ka qenë krejtësisht e panevojshme. Kjo kërkesë natyrisht është shpallur e papranueshme nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në dhjetor të vitit 2018, Presidenti kërkon dokumentacion shtesë për përshtatshmërinë e kandidatëve të nominuar nga grupet parlamentare, në atë e-mail që ne kemi pranuar, i është kërkuar Grupit Parlamentar të LDK-së të nominojë një anëtar, duke konfirmuar kështu përpjekjen e Presidentit për ta emëruar një përbërje antikushtetuese të KQZ-së. Mosfunksionimi i KQZ-së ka pamundësuar shumë aktivitete, si të KQZ-së, ashtu edhe të subjekteve politike, të cilat varen nga fondet që ndahen nga KQZ-ja për parti politike. Zyrtarët e partive politike dhe grupeve parlamentare kanë tre muaj që nuk marrin paga për shkak se KQZ-ja nuk është funksionale për të ndarë fonde për parti dhe për grupe parlamentare.

Të nderuar deputetë,

Shkelje e Kushtetutës është edhe mosveprimi njëvjeçar i Presidentit. Ja argumentet: neni 34, pika 2 i Kushtetutës thekson qartë se Presidenti është i obliguar të garantojë funksionimin kushtetues të institucionet të përcaktuara me Kushtetutë. KQZ-ja është institucion i përcaktuar me Kushtetutë me nenin 139. Nga data 27 mars 2018, që është afër një vit, Presidenti me mosveprimin e tij, pa asnjë arsye objektive e ka pamundësuar funksionimin kushtetues të institucioneve të parapara me Kushtetutë, në këtë rast të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pra, e ka shkelur nenin 84, pika 2 të Kushtetutës.

Një argument tjetër, ka më shumë se një vit që 35 apo 37 këshilltarë komunalë dhe një deputet i Kuvendit të Kosovës nuk po certifikohen dhe si rezultat nuk mund të përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve që i kanë votuar. Prandaj, me mosemërimin e anëtarëve të KQZ-së, Presidenti ka shkelur të drejtat e qytetarëve për të qenë të përfaqësuar në institucionet qendrore dhe lokale. Unë besoj thellësisht se demokracia jonë e re parlamentare, në mungesë të sjelljes së përgjegjshme politike të zyrtarëve shtetërorë, ka nevojë për një Gjykatë Kushtetuese që ka rol aktiv, si gardiane aktive e Kushtetutës.

Prandaj, të nderuar deputetë, duke pas parasysh të gjitha këto fakte ne e mbështesim draft rezolutën e prezantuar, kërkojmë që në përputhje me Kushtetutën, me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të 26 gushtit 2014, Presidenti të emërojë menjëherë, pa asnjë vonesë, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Çdo veprim tjetër i Presidentit është antikushtetues dhe do të na detyrojë të dorëzojmë çështjen në Gjykatë Kushtetuese. Ne ftojmë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që të mbështesim këtë rezolutë, sepse e para është e bazuar në Kushtetutë dhe në ligj dhe, e dyta, thjesht e fton Presidentin që të kryejë obligimin e tij kushtetues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Reçica.

ELMI REÇICA: I nderuar kryetar i seancës!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Fillimisht dua të theksoj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është jashtëzakonisht i interesuar që ky institucion shumë i rëndësishëm i vendit tonë të jetë sa më shpejt funksional dhe të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha obligimet kushtetuese e ligjore dhe të ushtrojë kompetenca, të cilat janë të përcaktuara qartë.

Kjo nënkupton që sa më parë të emërohen anëtarët e KQZ-së dhe, pa dilemë jemi të përkushtuar që të japim kontributin tonë në ruajtjen dhe forcimin e këtij institucioni. Po ashtu, e vlerësojmë që kjo seancë dhe rezoluta e propozuar nuk i kontribuon aspak forcimit të këtij institucioni dhe është ndërhyrje direkte në përgjegjësitë e Presidentit, të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë. Republika e Kosovës është e ballafaquar me një situatë të tillë, ku kemi pasur dy koalicione dhe një subjekt tjetër dhe si rezultat i kësaj, edhe mungesës së rregullave ka ardhur deri te një vonesë e emërimit të anëtarëve të KQZ-së. Për të hequr të gjitha dilemat Presidenti i është drejtuar edhe Gjykatës Kushtetuese, e cila ka nxjerrë një vendim, përmbajtjen e të cilit e dinë të gjithë dhe që duhet të zbatohet. Ne si grup parlamentar jemi dëmtuar më së shumti nga kjo gjendje, pasi kemi një deputet që pret në radhë për t'u zëvendësuar. Të gjithë e kemi të qartë se sa është me rëndësi që të kesh një deputet më tepër, sidomos në rrethanat çfarë jemi ne tash dhe ju e dini që këtu në këtë seancë dhe jo një herë ka ndodhur që mungesa e një deputeti nuk ka kaluar një vendim, një projektligj ose nuk ka pasur kuorum votues për t'u votuar gjërat, të cilat ose vendimet cilat kanë ardhur nga Qeveria ose kanë qenë pjesë e punës dhe angazhimit të Parlamentit.

Po ashtu, kemi edhe një numër të madh të asamblistëve nga komunat e ndryshme, të cilët presin zëvendësimin. Mendojmë se çdo vonesë në emërimin e anëtarëve të KQZ-së është e dëmshme për këtë institucion, po aq sa mendojmë që është edhe më e dëmshme edhe krejtësisht e pakuptimtë ndalimi i veprimtarisë dhe i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të KQZ-së aktuale, faktikisht defunksionalizimi i KQZ-së. Është e pakuptimtë për faktin se nuk ka pasur asnjë

vendim për pushimin e mandatit të anëtarëve aktualë të KQZ-së dhe as për zëvendësimin e tyre. Gjithashtu, ne të gjithë e dimë praktikën nga e kaluara, sipas të cilës anëtarët e KQZ-së kanë vazhduar të kryejnë detyrat e tyre deri në emërimin e anëtarëve të rinj, prandaj siç thashë edhe më sipër, është e pakuptueshme ndërprerja e punës së KQZ-së. Mendoj se ka qenë politike edhe e qëllimshme bllokimi i KQZ-së nga anëtarët të caktuar të partive politike, përkundër që kanë vazhduar të marrin rroga, por nuk kanë marrë pjesë në takimet e KQZ-së, e kjo është non sens. Kjo bllokadë ka qenë e qëllimshme për faktin se në këtë mënyrë është tentuar të bllokohet puna e këtij Kuvendi, kur dihet se edhe një votë e një deputeti është shumë e rëndësishme për këtë institucion. Ne e dimë se KQZ-ja e emëruar në vitin 2008, edhe përkundër faktit se ka pasur zgjedhje në vitin 2010 dhe është konstituuar Kuvendi, ka vazhduar të jetë në detyrë deri në dhjetor 2014, duke organizuar edhe disa procese zgjedhore, në vitin 2013 zgjedhjet lokale dhe në vitin 2014 zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Pra, në të njëjtën gjendje juridike.

Prandaj, kjo praktikë është dashur të vazhdohet gjatë kësaj kohe, dhe jo të bllokohet funksionimi i një institucioni për qëllime të politikës ditore. Të gjitha këto argumente dëshmojnë se seanca e sotme është e panevojshme dhe është e panevojshme dhe e papranueshme rezoluta e propozuar. Ne si Kuvend e kemi të qartë cilat janë detyrat tona dhe është e papranueshme ndërhyrja në kompetencë të Presidentit, ashtu siç është e papranueshme ndërhyrja e Presidentit në punën e Kuvendit. Ne si grup parlamentar kërkojmë që Presidenti sa më parë t'i emërojë anëtarët e KQZ-së në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe të vijë deri te zhblokimi i këtij institucioni shumë të rëndësishëm për vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.

ALBULENA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ka kaluar më shumë se një vit prej kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po mbahet i bllokuar dhe, në fakt po mbahet peng i interesave e pazareve të politikës ditore.

Një institucion kushtetues i pavarur e i përhershëm, shumë i rëndësishëm për përgjegjësitë që i ka për të organizuar dhe garantuar zgjedhje me integritet. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç e dini, nuk është kompetencë e Presidentit të bëjë pazare me territorin, siç duket ai ka keqkuptuar pozitën që mban, sepse kompetencë e tij është garantimi i funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, siç parashihet me nenin 84, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Por, ky President që pasi degradoi Qeverinë, e dëmtoi vendin si kryeministër, tash po degradon çdo institucion tjetër e po e shkatërron Republikën e Kosovës. Ajo çfarë ka ndodhur deri më tani është përdhosja dhe shkelja njëvjeçare e Kushtetutës, duke e mbajtur të bllokuar Komisionin Zgjedhor të Zgjedhjeve.

Fillimisht, siç e ka bërë zakon, Presidenti Thaçi ishte munduar të keqpërdorë Gjykatën Kushtetuese për të marrë përgjigjen që e do ai. Pra, ka kërkuar përgjigje nga Gjykata Kushtetuese se kujt i takojnë vendet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ani pse kjo është shumë e qartë. Gjykata Kushtetuese e shpalli të papranueshme kërkesën e Presidentit dhe ka bërë mirë që e ka shpallur të papranueshme dhe ja pse: Kosova është përcaktuar për modelin e pastër politiko-partiak në KQZ, me përjashtim të kryesuesit të KQZ-së, që vjen nga radhët e sistemit gjyqësor. Roli i Presidentit është konfirmimi i nominimeve të subjekteve politike dhe kur jam te subjektet politike, në bazë të Ligjit për zgjedhje kriteri i subjektivitetit politik që nënkupton parti politike, koalicion apo iniciativa qytetare përdoret në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në faza apo operacione të tjera zgjedhore në kuadër të procesit zgjedhor, sidomos në emërimin e komisioneve komunale zgjedhore nëpër secilën komunë dhe emërimin në përbërjen e këshillave të vendotimeve në ditën e zgjedhjeve. Kjo referencë ligjore ndjek me të drejtë parimin dhe kriterin e përbërjes së KQZ-së, ndryshe mund të thuhet se vetëm një përbërje legjitime kushtetuese e KQZ-së mundëson edhe përmbushje të ligjshme të kompetencave të KQZ-së.

Nisur nga fryma e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, mbështetur në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe në bazë të vendimit të KQZ-së për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të përgjithshme, në këtë rast të 11 qershorit, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të përbëhet nga anëtarë që përfaqësojnë grupet parlamentare që kanë dalë si subjekte politike, pra që kanë marrë pjesë në zgjedhje, sepse kjo lidhet me rezultatin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Pra, subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor. Po, shtrohet pyetja pse Presidenti Thaçi po e mban të bllokuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve? Përgjigjja mund të gjendet në dy drejtime: së pari, në interesat që ka PDK atje, partia që deri dje e drejtonte formalisht zoti Thaçi, kurse praktikisht vazhdon ta përfaqësojë. Dhe, së dyti, te logjika tregtuese e Presidentit Thaçi. Ai në fakt po keqpërdor gjithçka vetëm e vetëm që të mund të sigurojë përkrahje në aventurat e tij të rrezikshme për shkëmbimin territorial, për pazaret e tij të mëdha me Serbinë, po bën pazare më të vogla të brendshme. Pra, ai po bën pazare, sepse siç e kemi thënë, një ditë para miratimit të rezolutës për dialogun, zyra e tij ka dërguar kërkesën tek të gjitha grupet parlamentare për dërgim të propozimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Dhe, në këtë mënyrë ai po mundohet që një pakicë qeveritare e politike, bashkë me ca të ikur dëshpërimisht dhe artificialisht, t'i bëjë shumicë në KQZ. Ndërsa, një President pa legjitimitet, i devaluuar vetë në të gjitha anët, po synon të devalvojë gjithçka jashtë tij.

Por, arsyeja tjetër është po ashtu fakti se ai është ende i tronditur nga rezultati i zgjedhjeve të jashtëzakonshme të vitit 2017, sepse qytetarët i dhanë mbështetje më të madhe Lëvizjes Vetëvendosje, por siç duket, ai do të vazhdojë të tronditet, sepse kjo rritje përkrahje po shtohet çdo ditë e më shumë. Si pasojë e këtij bllokimi u tha edhe këtu, rreth 40 asamblistë presin më shumë se një vit për të marrë detyrën, siç u tha po ashtu, shumë kuvende komunale janë dëmtuar nga moscertifikimi i këtyre asamblistëve. Shumë projekte, aktivitete të KQZ-së kanë dështuar,

pra ky president ka rrënuar integritetin e këtij institucioni kushtetues. Dhe, unë nga kjo foltore e Kuvendit i ftoj sot të gjithë ata asamblastë, madje edhe deputetët, që po iu cenohen të drejtat kushtetuese nga Presidenti Thaçi, t'u drejtohen gjykatave për këtë shkelje të paprecedent. KQZ duhet të reflektojë rezultatin e zgjedhjeve të 11 qershorit të 2017, me përfaqësim të barabartë në mes të tri subjekteve politike që kanë dalë nga zgjedhjet. PAN, dy anëtarë, Lëvizja Vetëvendosje, dy anëtarë, LDK, dy anëtarë.

Më 21 dhjetor 2018, Lëvizja Vetëvendosje ka dërguar dy emra për përfaqësim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ashtu siç na takon edhe me Kushtetutë, edhe me ligj, edhe me aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, por po bëhen tre muaj që Presidenti në kundërshtim me afatet ligjore nuk i ka dekretuar dhe nuk ka funksionalizuar institucionin. Lëvizja Vetëvendosje nuk do të lejojë shkeljen e vullnetit të qytetarëve dhe as përdhosjen e Kushtetutës dhe ligjit. Ne i kërkojmë Presidentit Thaçi që sa më parë të bëjë dekretimin e anëtarëve të KQZ-së, duke u bazuar në Kushtetutën e vendit, Ligjin për zgjedhjet dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në të kundërtën, çfarëdo vendimi kundër Kushtetutës do të kundërshtohet fuqishëm. Dhe, tani më lejoni t'ju njoftoj që, pavarësisht nëse ai dekreton apo jo, ne jemi duke e menduar çështjen që ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, sepse ai edhe me këtë mosveprim po bën shkelje kushtetuese. Prandaj, besoj që javën e ardhshme ne do ta kemi të finalizuar lëndën për ta dërguar Presidentin Thaçi në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se ai e ka për obligim që të garantojë funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë dhe që një vit e më shumë po e mban të bllokuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duke e ditur se që një vit nuk është duke funksionuar Komisioni Qendror Zgjedhor, kërkon nga Presidenti që sa më shpejt ta bëjë dekretimin e anëtarëve të grupeve parlamentare, të cilët janë propozuar për Komisionin Qendror Zgjedhor, duke pasur parasysh edhe pasojat që i kemi pasur gjatë kësaj periudhe, sidomos në asambltetë komunale, në kuvendin e Kosovës, në buxhetet që ishte dashur t'ju ndahen grupeve parlamentare dhe partive politike dhe duke qenë se janë të ndërlidhura edhe pengesat në institucionet e tjera, atëherë ky veprim duhet të bëhet sa më shpejtë që është e mundur.

Meqë kemi të bëjmë edhe me pjesë të ligjeve, të Kushtetutës, atëherë t'u përmbahemi këtyre rregullave dhe të bëhet sa më shpejtë kompletimi i Komisionit Qendror Zgjedhor. Grupet parlamentare siç e dimë i kanë dërguar emrat dhe presim certifikimin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja. Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate mbështet kërkesat apo deklaratimet e të gjitha grupeve parlamentare këtu, gjegjësisht iu bashkohet atyre për funksionalizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Po ashtu, të përkujtojmë se tashmë janë jofunksionale, ose së shpejti do të bëhen edhe një varg institucionesh të tjera të pavarura, për shkak se iu kalon apo tashmë iu ka skaduar mandati anëtarëve të bordeve, e përgjegjësinë për emërimin e tyre e ka Kuvendi. Kështu që edhe ne si Kuvend besoj se duhet të bëhemi më të përgjegjshëm dhe t'i emërojmë në kohë anëtarët e bordeve të institucioneve për të cilat ne jemi përgjegjës. Natyrisht i bëjmë thirrje Presidentit që sa më shpejtë t'i emërojë anëtarët e KQZ-së në mënyrë që ky institucion të funksionalizohet.

E përmendi edhe zoti Ahmeti, tashmë grupet parlamentare i kanë dërguar propozimet e tyre dhe konform Kushtetutës dhe Ligjit për zgjedhje, Presidenti duhet t'i emërojë anëtarët e KQZ-së. Në rast se ai nuk i emëron dhe një vendim i tillë duhet në një formë apo tjetër të merret nga KQZ-ja, natyrisht se ne do ta mbështesim atë. Pa marrë parasysh nëse ai do të jetë në favor tonin apo kundër.

Është interesante në fakt se në rezolutë, dhe ne e mbështetim pjesën e parë të rezolutës, e cila thirret në Kushtetutë dhe në ligj, por është aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të cilin partitë opozitare aktuale më së shumti e kanë kundërshtuar, duke e quajtur atë jokushtetues, dhe duke e quajtur madje duke e akuzuar KQZ-në se po ia mban anën në atë kohë koalicionit i cili kishte dalë i pari në zgjedhje dhe po e cungonte demokracinë në vend. Dhe tashti thirrëmi në të njëjtin aktgjykim. Pra, kur na pëlqen ne thirrëmi në të e nëse nuk na bie tamam neve, ne e kundërshtojmë atë. Mendoj se në demokraci duhet të mësojmë t'i respektojmë vendimet edhe atëherë kur ndoshta nuk janë në favorin tonë.

Edhe një herë i bëjmë thirrje Presidentit që t'i emërojë anëtarët e KQZ-së duke u bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin për zgjedhje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Bilall Sherifi në emër të Nismës.

BILALL SHERIFI: Po pasi dolën këta t'i japin seriozitet këtu, thashë të dal edhe unë këtu t'i jap seriozitet pak më të madh Albulenës këtu. Faleminderit!

Vërtet, veç do të kisha, në fakt nuk do të kisha dalë fare këtu, por do ta kisha thënë një fjali prej vendit në emër të Nismës. Nëse rezoluta do të kufizohej vetëm në të drejtën që e ka Kuvendi, të bëjë ftesë që sa më shpejtë të plotësohet KQZ-ja duke u bazuar në kompetencat kushtetuese që i ka Presidenti dhe pasi ai të marrë vendim, palët e pakënaqura t'i drejtohen institucionin që është i thirrur apo është i mandatuar për të interpretuar Kushtetutën dhe pastaj kur vendimi do të vinte, prapë të pakënaqurit, mund të isha unë në këtë rast, do të mund të protestoja, por do të isha i

detyruar ta pranojë vendimin. Por meqë këtu përpos që u kërkuar që sa më shpejt të emërohet KQZ-ja ku u tregua edhe sesi duhet të emërohet KQZ-ja. Pra, këtu dolëm për mendimin tim nga mandati i deputetit dhe prandaj dola edhe unë këtu për të dalë tash edhe unë pak nga mandati i deputetit. Jo për të ndenjtur brenda mandatit, por edhe unë pak për të dalë jashtë mandatit.

Duke pasur parasysh që Kushtetuta, përkatësisht neni 6, dhe pastaj do të dalim edhe te aktgjykimi. Shoku Sami mbaj shënim se me ty më shumë e kam si folësi kryesor i kësaj. Thotë neni 139, paragrafi 4, thotë: gjashtë anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, pra më pak se gjashtë, grupi apo grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë, që në rastin tonë jemi gjashtë grupe parlamentare i bie nga një. Interpretimi juaj, jemi tri grupe parlamentare, na takojnë nga dy. Sikur të ishim dy grupe parlamentare, sipas Kushtetutës, do t'ju takonin nga tre. Pra, nuk i keni nga dy në Kushtetutë të rezervuara, por secili grup parlamentar e ka nga një.

Tash vijmë te aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për grupet parlamentare. Ju po e interpretoni vetëm pjesën e parë. Së paku kjo është tash këndvështrimi im. Po e interpretoni pjesën e parë ku thotë se çka është grupi burimor parlamentar që vlen derisa të krijohen institucionet, derisa të konstituohet Kuvendi dhe të themelohet Qeveria. Interpretimi i Gjykatës Kushtetuese thotë kështu: grupet parlamentare nuk mund të ndryshojnë derisa nuk është konstituuar Kuvendi. Dhe, grupi më i madh parlamentar ka të drejtë të propozojë Kryetarin e Kuvendit, kandidatin për Kryetar të Kuvendit dhe që Kryeministri, përkatësisht mandatarin për Qeveri.

Nga ky moment kur kjo të përfundojë, deputetët janë të lirë të formojnë grupe parlamentare. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e thotë këtë, nuk e them unë. Pra, kufizimi për grupin parlamentar vlen vetëm derisa të konstituohet Kuvendi dhe të formohet Qeveria. Nga ai moment kur të përfundojë ky proces, deputetët janë të lirë.

Kur vjen në shprehje tash neni 139 për KQZ-në, a vjen në shprehje para se të konstituohet Kuvendi apo pasi të konstituohet Kuvendi? Kur Presidenti është i detyruar të veprojë për të kërkuar anëtarë nga grupet parlamentare anëtarë për KQZ? Kjo ndodh në momentin, në momentin pasi të konstituohet Kuvendi dhe pasi të formohet Qeveria. Nga ai moment, deputetët janë të lirë të krijojnë grupe parlamentare. Dhe Presidenti dhe çdokush tjetër nuk është i detyruar t'i referohet rezultatit të zgjedhjeve, sa i përket, së paku ky është këndvështrimi im, nuk është i detyruar t'i referohet rezultatit të zgjedhjeve sa i përket KQZ-së, po gjendjes në të cilën gjendet Kuvendi në momentin ku ai bën ftesë për të emëruar kandidatë për KQZ, anëtarë për KQZ, secilit grup parlamentar.

Prandaj mendoj që është interpretim i anshëm dhe unë mendoj që këtu aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk e ka zgjidhur këtë çështje. Mund ju të keni të drejtë, nuk po e kontestoj, por për

mendimin tim nuk është e përfunduar interpretimi për KQZ. Ai interpretim nuk vlen për KQZ-në. Nuk e përfundon deri në fund, sepse le që nuk e përfundon, por merreni lexojeni mirë aktgjykimin. Ju jep liri, të drejtë kushtetuese thotë kanë deputetët, nga ai moment që të krijohen institucionet në Kosovë, ato të veprojnë të lira. Këtë e kanë bërë deputetët e PAN-it.

Pra, nga tri subjekte politike që kanë garuar dhe kanë dalë në një grup parlamentar derisa janë konstituuar organet, përkatësisht Kuvendi, Kryesia e Kuvendit dhe Qeveria, kanë shfrytëzuar të drejtën jo vetëm kushtetuese, por edhe të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për të krijuar grupe parlamentare dhe për të kërkuar që të shfrytëzojnë të drejtën të kenë anëtarët e tyre edhe në KQZ. Ky është interpretimi i Nismës, të cilin ia kemi dërguar edhe Gjykatës Kushtetuese kur ka kërkuar mendim në pyetjen që është shtruar nga Presidenti. Ata, ju e dini që kanë thënë së paku as sa unë kam njohuri, kanë thënë s'kemi lëndë për të trajtuar. Pse s'kemi lëndë? Sepse njëherë duhet Presidenti të veprojë, duhet, e kanë shpallur të papranueshme kërkesën.

Pra, le të veprojë Presidenti, le të krijohet akti, pastaj shkojnë palët e pakënaqura në Gjykatë Kushtetuese, nëse do t'i emëronte dy nga dy nga dy, siç thoni ju, Nisma do të ankohet në Gjykatë Kushtetuese, sepse unë mendoj që ne kemi të drejtë si grup parlamentar të gëzojmë të drejtë kushtetuese që të kemi anëtarin tonë në KQZ. Mund të keni ju të drejtë, madje edhe mund të mos keni të drejtë, po Gjykata Kushtetuese mund t'ju japë. Ne nuk mund ta rrëzojmë. Mund ta kontestojmë, mund të mos e pranojmë, mund të mos pajtohemi se në fakt jemi të detyruar ta pranojmë. Por rrjedha e gjërave unë mendoj që kështu do të duhej të shkonte.

Prandaj, shfrytëzoj rastin këtu në foltore të bëjë ftesë publike që sa më shpejt të zgjidhet kjo çështje. Le të vendos siç ai beson se është i detyruar të vendosë. Unë mendoj që duhet të vendosë gjashtë grupeve parlamentare t'ua japë nga një. Nëse ai mendon ndryshe, le të veprojë, por le të veprojë, që të hapet rruga palët të cilat mund ta konsiderojnë vendimin të padrejtë dhe të ndahen të pakënaqura t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese që përmes një aktgjykimi tjetër të trajtojë edhe këtë çështje, sepse çështjen e KQZ-së apo e veprimt e të drejtave të deputetëve, pasi të kenë krijuar grupe parlamentare, nuk e ka trajtuar Gjykata Kushtetuese.

Pra, përderisa me Aktgjykimin ju jep të drejtë të formojnë grupe parlamentare, meqë tash ne nuk po arrijmë të merremi vesh këtu, duhet të shkojmë te Gjykata Kushtetuese dhe të themi se cilat janë pra të drejtat e grupeve parlamentare që krijohen pasi të konstituohen organet e Kuvendit, Kuvendi. A i gëzojnë të gjitha të drejtat si grupet burimore, apo nuk i gëzojnë të gjitha të drejtat? Unë do t'iu bashkëngjitesha në këtë pjesë, që sa më shpejt të zgjidhet kjo çështje duke marrë një vendim, por jo pjesët tjera të cilat mendoj që del përtej mandatit tonë si deputet. Faleminderit!

KRYESUESI: Ti djalë ose dil jashtë ose rri brenda atje, ti me telefon në vesh atje. Ose dil jashtë, ose ulu si të gjithë të tjerët që janë ulur. Replikë? Mirë, zonja Haxhiu, replikë!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Më duket që nëse do të mbështjellësh diçka, më së miri është t'ia lësh Bilallit, sepse Bilalli fort mirë e di këtë punë.

Kështu! Janë disa çështje që do të doja që t'i theksoj këtu. E para ka të bëjë me nenin 139, paragrafi 4 i Kushtetutës, që nënkupton grupet parlamentare në kuptimin e subjekteve politike që kanë kaluar pragun zgjedhor.

Dy, është çështja e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, që u tha edhe nga një deputete që së pari s'e keni pranuar, tash po i referoheni. Ajo çfarë do të doja të shtoja këtu, është po ka qenë vendim i padrejtë, por megjithatë tash ne jemi të obliguar ta respektojmë atë, derisa s'ndryshon Kushtetuta e vendit, e kemi atë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese. Ky përkufizim është kështu: rrjedhimisht, thotë Gjykata Kushtetuese, grupi më i madh parlamentar sipas nenit 67 duhet të konsiderohet partia, koalicioni, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë më shumë vende në Kuvend, në kuptim të nenit 64.

Dhe, një çështje tjetër që është jashtëzakonisht e rëndësishme, ka të bëjë me Ligjin për zgjedhjet, që thotë: mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se 60 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Pra, ky afat lidhet me ditën e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe jo me ditën apo datën e konstituimit të Kuvendit. Edhe duke e marrë parasysh që konstituimi i Kuvendit mund të shtyhet, madje nëse nuk konstituohet vendi mund të shkojë në zgjedhje apo jo dhe ideja është që KQZ-ja të funksionalizimet në momentin kur të certifikohet rezultati i zgjedhjeve, që nuk lidhet me konstituimin e Kuvendit. Pikërisht për faktin se kjo mund të marrë kohë, vendi mund të shkojë në zgjedhje dhe kur të shkojë vendi në zgjedhje ne duhet ta kemi një KQZ funksionale, apo jo?

Prandaj, i thërras të gjithë deputetët që ta lexojnë Kushtetutën siç duhet, edhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, por edhe Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kudër-replikë, z. Sherifi!

BILALL SHERIFI: Së pari, kryesues, unë kur fillova diskutimin nuk ia përmenda emrin. Mirë që ia dhe fjalën se është demokraci kjo, po Albulenë, unë jam i çliruar nga kompleksi i babës, çka të thotë babai të dalë dhe ta thotë në mëhallë. Unë flas atë që e besoj dhe nëse ato unë i them ty nuk të pëlqejnë, ato pastaj kanë të bëjnë me ty nuk kanë të bëjnë me mua.

Unë nuk mund të të shërojë ty nga komplekset që i ke që të mbahen në ballë ato që nuk të lënë të shikosh anash. Unë për vete, gjithmonë, tërë jetën e kam thënë mendimin tim, bindjet e mia ashtu siç unë i kam parë, por asnjëherë nuk kam absolutizuar siç po absolutizon ti. Edhe në fjalën time kur e thashë unë u përpoqa të jap këndvështrimin tim.

E di që ty nuk të pëlqen, por mbaje nivelin e debatit dhe rri në përmbajtje, mos jep cilësime të panevojshme se pastaj cilësimet sjellin cilësime.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kolege dhe kolegë deputetë,

Zonja zotërinj,

Qytetarë të nderuar,

Pa dashur që t'i përsërisë ato që i thanë paraprakisht parafolësit edhe kolegët e mi të nderuar, është evidente që jemi duke diskutuar për një çështje jashtëzakonisht të ndjeshme dhe sensitive që ka të bëjë me komisionin apo funksionalizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Prandaj, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar 6+ t'i them disa fjalë lidhur me këtë temë në këtë seancë të jashtëzakonshme.

Sa për informacionin tuaj edhe ne si Grup Parlamentar 6+, të nderuar deputetë, kemi nominuar që në fillim anëtarët tonë për emërimin si anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kemi dërguar dokumentacionet e nevojshme të të nominuarve në Zyrën e Presidentit, e po ashtu jemi në pritje të nominimit.

Siç e dimë, kërkesa e dërguar e presidentit tek Gjykata Kushtetuese për interpretim për nominim të anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe intervali kohor, derisa gjykata e ka bërë interpretimin e saj, duke u bazuar që në atë kohë gjykata nuk ka pasur kuorum, s'ka qenë funksionale, pra nuk kishte të anëtarë të saj për t'u marrë me interpretimin e kërkesës së bërë nga Presidenti i Kosovës. Pra, e gjithë kjo ka marrë kohë dhe e ka prolonguar këtë proces shumë të rëndësishëm.

Personalisht, po besoj që edhe kjo çështje ka të bëjë me mosemërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe vonesa për emërim të anëtarëve vjen si rezultat i hapësirave interpretuese të Kushtetutës, pra hapësirat ose boshllëqet në interpretim të ligjit po besoj që na sjellë deri në këtë pikë.

Gjithashtu, mendoj se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo KQZ-ja si institucion tepër i rëndësishëm i Republikës së Kosovës duhet të jetë i konsoliduar sa më parë sepse Komisionin Qendror të Zgjedhjeve e presin goxha punë dhe përgjegjësi në zëvendësimin e deputetëve të cilët duhet të certifikohen. Gjithashtu edhe zëvendësimin e asamblistëve në kuvendet komunale nëpër komuna të ndryshme.

Sidoqoftë, ne si grup parlamentar shpresojmë dhe besojmë që presidenti sa më parë ta përmbush obligimin e vet kushtetues duke i emëruar anëtarët e Komisionin Qendror Zgjedhor në mënyrë që ky institucion shumë i rëndësishëm të funksionalizohet, ngase është njëri ndër institucionet më vitale në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit, shef! Fjalën e ka Fidan Rekaliu.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kërkoj që të emërohen sa më parë anëtarët e KQZ-së me qëllim të krijimit të kushteve të funksionimit normal të kuvendeve komunale në Republikën e Kosovës. Njëkohësisht është bërë një padrejtësi e madhe edhe ndaj këshilltarëve të rinj të asambleve komunale për shkak se nuk iu është mundësuar atyre që të kontribuojnë për qytetet prej nga vijnë ata.

Andaj, edhe njëherë kërkoj që të emërohen sa më parë anëtarët e KQZ-së. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Luljeta Veseli-Gutaj, urdhëroni!

LULJETA VESELI-GUTAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Seanca e thirrur sot nga opozita lidhur me KQZ-në, unë mendoj se është ndërhyrje direkt në institucionin e pavarur dhe kushtetues siç është institucioni i KQZ-së.

KQZ-ja ka kohë që nuk po mund të marrë vendime si pasojë e bllokadës nga ana opozitës e përfaqësuar në këtë institucion. Kemi argumente ligjore dhe kushtetuese se puna e KQZ-së nuk do duhej të ndërpritej si pasojë e egos së opozitës për qëllime politik.

Nuk ka asnjë dekret të presidentit për pezullim apo ndërprerje të mandatit të anëtarëve të KQZ-së.

Për t'i hequr të gjitha këto dilema, po dëshiroj vetëm t'ju rikujtoj se pas zgjedhjeve të dhjetorit 2010 nuk është rimanduar KQZ. Dhe kjo ka ndodhur vetëm me anëtarë që kanë humbur të drejtën e përfaqësimit. Pra, KQZ-ja e ka vazhduar punën deri në qershor të viti 2014, kur edhe janë shpallur zgjedhjet e përgjithshme.

Pra, në gjendjen aktuale ligjore dhe kushtetuese në të cilën gjendet sot KQZ-ja, ka mbajtur zgjedhjet lokale më 3 nëntor 2013, si dhe ka mbajtur zgjedhjet e përgjithshme më 8 qershor 2014.

Pra, nga një situatë tërësisht e ngjashme KQZ ka prodhuar efekte juridiku duke i legjitimuar institucionet e dala nga më shumë se dy palë zgjedhje. Vetëm pas gjithë kësaj është bërë betimi më 15 dhjetor 2014.

Arsyet pse presidenti akoma s'ka bërë dekretim janë të njohura. Ai ka dashur t'i heqë të gjitha dilemat kushtetuese dhe se lënda ka shkuar për trajtim në Gjykatën Kushtetuese dhe është kthyer një përgjigje, por që presidenti duke e parë se prapë kjo çështje po tentohet të përdoret politikisht, duke i kërcënuar prapë më dërgim në Kushtetuese, atëherë do të marrë një vendim meritor në kohën dhe momentin e duhur.

Mendoj, se KQZ shumë shpejt duhet të bëhet funksionale dhe ne si Kuvend duhet t'i bëjmë thirrje kryetares Daka të fillojë me punën sipas përgjegjësive që ka. Unë konsideroj se më e dëmtuara aktualisht nga të gjitha subjektet politike është Partia Demokratike e Kosovës.

Të gjithë e kemi të ditur se ne e kemi një deputet i cili po pret në radhë dhe kemi shumë asamblistë të tjerë të cilët presin që të zëvendësohen.

Kjo seancë dhe rekomandimet e kësaj seance dëshmojnë qartë se opozita edhe prej opozitës po synon të ndërhyjë në institucionet e pavarura dhe kushtetuese. Për mua është krejt e papranueshme një diskurs i tillë politik i cili e cenon rëndë pavarësinë e institucioneve të pavarura. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhelal Sveçla.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Për më shumë se një vit e gjysmë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u bllokua dhe vazhdon të mbahet peng nga Hashim Thaçi. Fillimisht duke e shkelur Kushtetutën me mosveprim për të emëruar anëtarët e KQZ-së në afatin e përcaktuar brenda 60 ditëve nga certifikimi i zgjedhjeve të 11 qershorit. Pastaj me zvarritje përmes kërkesës kinse për sqarim nga Gjykata Kushtetuese për diçka që ishte edhe e qartë edhe e sqaruar paraprakisht.

Ndërkaq kur i përfunduar të gjithë skenarët e bllokimit po synon ta degradojë KQZ-në deri në rrënim përmes emërimit të anëtarëve të KQZ-së në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës.

Praktikën e deritanishme. Aktgjykimin e Gjykatëse Kushtetuese për grupet parlamentare dhe standardet ndërkombëtare për trupat e administrimit të zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i rëndësishëm kushtetuese dhe i pavarur, ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e të cilit është parakusht për garantimin e paanshmërisë dhe integritetit të zgjedhjeve. KQZ ka nevojë për t'u ndihmuar e përmirësuar e jo për t'u bllokuar e degraduar.

Si institucion i rëndësishëm për demokracinë në vend ai nuk mund të përdoret për pazare të politikës ditore, interesa personale apo grupe.

Një pakicë qeveritare politike po përpiqet artificialisht të bëhet shumicë në KQZ, ndërsa një president pa legjitimitet, i devaluuar vet në të gjitha anët po synon të devalvojë gjithçka jashtë tij.

Në vend të përmbushjes së përgjegjësisë së tij kushtetuese për të garantuar funksionimin e organeve kushtetuese, ai po përpiqet përditë dhe kudo të shkatërrojë gjithçka shtetërore. Por, kësaj here prapa tij nuk është vetëm PSD, më falni PDK, kryetari i së cilës ishte, por edhe partitë tjera që dje ishin në koalicion, ndërsa sot janë bërë bashkë në aventurat e tij negociatore, si AAK, Nisma dhe PSD.

Përbërja dhe funksionet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të shihen nga këndvështrimi i ndikimit në integritetin e zgjedhjeve, besueshmërinë e paanshmërinë e procesit zgjedhor dhe ndërtimit të konsolidimit të demokracisë nëpërmjet garës zgjedhore të subjekteve politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje që kanë qenë të certifikuara nga ana e KQZ-së në zgjedhjet e fundit.

Kjo është norma dhe fryma që bartë Kushtetuta e Republikës e veçmas e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Andaj, çfarëdo cenimi i integritetit të KQZ-së siç po bën presidenti Thaçi, është cenim i demokracisë e shkelje e rëndë e ligjit dhe Kushtetutës së Republikës.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e përcakton qartë se mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se 60 ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve për Kuvend. Ky paragraf përtej afatit se kur duhet të fillojë më së voni mandati i anëtarëve të KQZ-së, e qartëson gjithashtu edhe kriterin ligjor mbi subjektet legjitime për të bërë nominime për anëtarët e KQZ-së, sikurse që e garanton mekanizmin e domosdoshëm për vazhdimësi institucionale të një institucioni të përhershëm kushtetues.

Po e theksojmë, ky afat lidhet me ditën e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe jo me ditën apo datën e konstituimit të Kuvendit.

Nga kjo shihet se funksionalizimi i KQZ-së nuk ka kurrfarë ndërlidhje me Kuvendin, por me rezultatin, respektivisht me subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe që kanë kaluar pragun zgjedhor.

Nisur nga kjo, nga zgjedhjet e 2017-ës kanë dalë tri subjekte politike legjitime për t'u përfaqësuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; koalicionin PAN, i cili duhet t'i ketë dy anëtarë, Lëvizja Vetëvendosje dy anëtarë dhe koalicioni LAA, respektivisht LDK-ja dy anëtarë.

Çfarëdo kalkulimi, pazari e kontrabandimi është veprim e vendim antiligjor dhe antikushtetues dhe si i tillë i papranueshëm.

Përpjekjet për t'i përdorur institucionet kushtetuese siç është KQZ për të paguar shërbimet dhe nënshtrimin e disa subjekteve ndaj Hashim Thaçit, janë të papranueshme dhe paralajmërimin i thellimit të zgjerimit të kapësve e të kapjes së shtetit.

Prandaj, është e rëndësishme jetike që sa më shpejt të bëhet nominimi dhe realisht funksionalizimi i KQZ-së nga Presidenti i Kosovës në mënyrë që edhe ky institucion ta fillojë punën sa më shpejt dhe sa më mirë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Më fal, a ta ka përmendur emrin? Po, urdhëroni Bilall Sherifi për replikë. I ke dy minuta.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesuese!

Unë në fjalën time nuk akuzova askënd as për aventura, as për veprime jashtë kushtetuese dhe as për asgjë tjetër. U ndala në temë dhe trajtova këndvështrimin e Nismës rreth kësaj çështjeje.

Kolegë deputetë ju lutem,

Mos hyni në insinuata e në shpifje e mos i shfaqni as halucinacionet e as paranojat tuaja këtu. Nisma s'ka hyrë në asnjë aventurë dhe nuk e ka ndërmend të hyjë në asnjë aventurë as për anëtarë të KQZ-së, as për deputet dhe për asgjë tjetër.

Ndaluni, diskutoni, debatoni për çështjen për të cilën e keni thirrur vet seancën. Mos dilni nga tema sepse nxisni pastaj debate. Nxisni reagime. Nuk mundesh ti të zgjohesh aty edhe të godasësh partitë majtas-djathtas. Të akuzosh dhe të shpifësh me halucinacione dhe paranoja tua edhe të presësh heshtjen pastaj. Të presësh duartrokitje edhe miratim të shpifjeve tuaja.

Ndajeni çështjen e bisedimeve. Ndajeni çështjen e dialogut. Ndajini çështjet tjera dhe flitni për KQZ-në. Mos i pështillni, sepse për ato që tjerët i akuzoni jeni duke i bërë vetë, duke pështjellë vetë.

Fakti që po ju dhemb shumë fjala ime, dëshmon që bash qysh kam thënë unë ashtu është. Pra, ndaluni mos hyni në tema të tjera. Ndaluni në temën për të cilën vetë e keni ftuar seancën.

KRYESUESJA: Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, fjalën e ka shefi i grupit, zoti Memli Krasniqi për replikë, urdhëroni!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Jo shumë për replikë sa me mirëprit edhe njëherë këtë debat e mbi të gjitha jam aq shumë i gëzuar që sot po e dëgjojmë një zell të jashtëzakonshëm të opozitës duke e mbështetur dhe duke u thirrur dhe duke iu referuar në mënyrë të vazhdueshme një aktgjykimi të Gjykatë Kushtetuese, të cilin vite më parë e quanin të paligjshëm.

E quanin të imponuar. E quanin të padrejtë. Dhe, sot krejt kjo seancë është thirrur dhe krejt çka po dëgjojmë prej partive në opozitë është që duhet t'i referohemi atij aktgjykimi. Më vjen mirë që me katër-pesë vjet vonesë e kanë kuptuar që ka qenë aktgjykim i drejtë, faleminderit prej tyre, edhe pas pesë vjetësh ta kuptosh dhe ta pranosh gabimin publikisht nuk është problem. Shpresoj t'i kuptojnë edhe gabimet e tjera, të cilat ndërlidhen me funksionimin e institucioneve dhe t'i pranojnë edhe institucionet e tjera siç e paskan pranuar Gjykatën Kushtetuese sot. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mimoza Kusari-Lila, urdhëroni!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Qeveri në mungesë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot po debatojmë për një prej organeve apo institucioneve më vitale të një demokracie, Komisioni Qendror Zgjedhor dhe një problem, i cili në një farë mënyre ose tjetër është bërë çështje e tekeve individuale ose grupore politike.

Funksionimi i këtij institucioni përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Jo pak dhe jo rrallë po shkelet kjo Kushtetutë nga vetë ata që duhet ta mbrojnë Kushtetutën.

Në anë të obligimeve dhe detyrimeve që i ka Presidenti i Republikës së Kosovës, ai e ka për detyrë me nenin 84 edhe të shpallë zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, edhe të emërojë kryetarin apo kryetaren e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Në rastin që po trajtohet, mosplotësimi i organit kyç për funksionimin e tij të përcaktuar me Kushtetutë nga ana e presidentit është jo vetëm shkelje e Kushtetutës, por gjithashtu edhe një bastardim i pozitës së Presidentit. Presidenti jorastësisht nuk po e kryen këtë obligim.

Në mënyrën dhe formën e vetë të praktikuar shumë shpesh tash në Kosovë, ai po tregon para qytetarëve të Kosovës se ai mban kontroll mbi procesin dhe krejt esenca e mosëmërimit të anëtarëve të Komisionit Qendror Zgjedhor është të tregojë që nëse ne po flasim për zgjedhje, a do të ketë zgjedhje, a shkojmë në zgjedhje, qytetarët çdo ditë e bëjnë këtë pyetje, është një njeri që u tregon të gjithëve se në zgjedhje mund të shkojmë kur do ai dhe ai është Presidenti i vendit, për arsye se nuk mund të shpallim zgjedhje përderisa s’kemi të plotësuar Komisionin Qendror Zgjedhor.

Tash ky proces nuk po e mban vendin peng vetëm për zgjedhje nivelin qendror, mungesa e plotësimi të këtij institucioni po e mban peng edhe funksionimin e katër komunave në veri, katër komuna në veri, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, sot e katër muaj nuk kanë kryetar zyrtarisht. Ata kanë dorëzuar letrat e dorëheqjes, megjithatë nga Qeveria është thënë se ato letra nuk janë valide, për shkak se në dorëheqjen e tyre janë thirrur si ‘Kosovë e Metohi’.

Ndoshta është koha që të presim dhe thotë populli “me një t’rame, dy të vrame”, tregojmë shkelje kushtetuese, edhe dy muaj na kanë mbetur, vetëm edhe gjashtë muaj edhe Qeverisë, edhe presidentit, dhe që të dytë do ta tregojnë se si mund të shkojnë në shtëpi jo me punën që kanë bërë, po me diçka që s’kanë bërë.

Tash, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 124, pika 6, komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe zbatojnë vendime gjyqësore, respektivisht katër komunat nuk e respektojnë Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet. Po kush është përgjegjës për mbikëqyrje të këtyre komunave. Rishikimi administrativ i akteve të komunave bëhet nga autoritetet qendrore, domethënë Qeveria duhet t’i rishikojë komunat.

Në anën tjetër, Ligji për vetëqeverisjen lokale përcakton se mbledhjet e kuvendit të komunës duhet të mbahen së paku 10, 5 në gjashtëmujorin e parë. Neni 50 tregon se kur shpërndahen kuvendet komunale, ato shpërndahen nëse nuk e zgjedhin kryesuesin, nëse nuk e miratojnë buxhetin, e tjera.

Ndërkaq pika d e nenit 50.2 e cek se kuvendet komunale shpërndahen nëse nuk mbajnë mbledhje për gjashtë muaj. Obligim apo përgjegjësi për shpërndarje të kuvendeve komunale është Ministria e Pushtetit Lokal, që është kompetencë e ekzekutivit.

Ministria përgjegjëse për Qeverisje Lokale njofton Qeverinë për mosfunksionim dhe Qeveria duhet ta shpërndajë kuvendin. Zgjedhjet e reja për kuvendin e komunës duhet të mbahen në pajtim me Ligjin për zgjedhje.

Natyrisht se këto kuvende komunale nuk janë mbledhur tash e katër muaj.

Vetëm edhe dy muaj, deputetë të nderuar, në veçanti ju të opozitës, nëse këto kuvende komunale nuk mbajnë takim, ne lirisht mund të nisim peticion për mbledhjen e nënshkrimeve për dorëzim në Gjykatën Kushtetuese, për shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës të udhëhequr nga Ramush Haradinaj dhe nga Presidenca të udhëhequr nga Hashim Thaçi për shkelje të Kushtetutës.

Ne kemi institucione dhe komuna jofunksionale dhe këta njerëz po rrinë e po bëjnë seri, përderisa afatet ligjore po ecin.

Domethënë nëse asnjë veprim tjetër nuk ndërmerret dhe të gjitha marrëveshjet apo ndarja e pushtetit po shkon mirë, për taksën s'po merremi vesh, po presim edhe dy muaj dhe e çojmë vendin në zgjedhje automatikisht, për arsye se të dy palët kanë shkelje kushtetuese.

Për shkeljet kushtetuese u dakorduar. Tash unë e kam një pyetje për krejt partitë politike që janë të përfaqësuara në Kuvend dhe të cilët i kanë deleguar anëtarët ose emrat për KQZ.

Jemi në muajin mars, muajin e grave, krejt dhe krejt e kanë gojën kur po thirrin konferenca, në veçanti burrat të flasin sa janë të prirur t'u jepet grave pushtet e kompetencë, e të tjera, e të tjera. Kisha pasur një pyetje publike për krejt partitë politike: A keni emëruar ose deleguar ndonjë grua prej partive tuaja të ju përfaqësojë në KQZ? A janë gratë ato të dinjitetshme mjaftueshëm, Vetëvendosja po, okej, të tjera partitë, PSD-ja, po, shumë mirë social demokratë. A janë gratë të mjaftueshëm të dinjitetshme t'ju përfaqësojnë në KQZ, interesat tuaja, a keni pasur deri tash gra të cilat kanë përfaqësua interesat e partive politike në KQZ, ju kisha lutur, prej fjalëve në vepra.

Nëse po duam të shkojmë në zgjedhje, mund të presim vetëm edhe dy muaj dhe e kemi kryeministrin dhe Presidentin në shkelje të Kushtetutës. Ndërsa, kur të vjen puna e muaji i grave, ju kisha lutur, mundësisht të na tregoni me vepra e fjalë në këtë muaj mars të na kurseni, se bash jemi lodhur prej tyre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi. Për replikë fjalën e ka Albulena Haxhiu. Urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Nuk e kam për replikë, sepse pajtohem me atë çka tha zonja Kusari Lila, vetëm për t'u qartësuar.

Po, Lëvizja Vetëvendosje ka propozua dy emra, Adnan Rrustemin dhe Nazlije Balën. Prandaj ne po insistojmë që këta të dy të dekretohen nga Presidenti Thaçi, siç e thashë edhe më përpara, çfarëdo vendimi tjetër do të jetë i papranueshëm për ne, pikërisht sepse ne besojmë në barazi, prandaj kemi propozuar një burrë dhe një grua. Faleminderit!

KRYESUESJA: Nejse, Albulena, ke shfrytëzuar rastin, ke kërkuar fjalën për replikë. Urdhëro, Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se potpredsednice Parlamenta!

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani naše države,

Dugo godina smo čekali javnu debatu oko funkcionalnosti rada Centralne Izborne Komisije.

Te koristim priliku da vas sve ovde prisutni informišem o pravoj istini oko izbora Bošnjackog člana Centralne Izborne Komisije ili KQZ-a.

Bazirajući se na Ustav Republike Kosova, član 139, tačka 6, Zakona o opštim izborima, član 61, tačka 3, odnosno izbor članova iz redova manjinskih zajednica.

Javno zahtevamo od predsednika Republike Kosova gospodina Hashima Thaçi da bude prvi predsednik ove države koji će mesto člana Centralne Izborne Komisije tretirati ravnopravno, i rotaciono kao što je to slučaj sa ostalim zajednicama.

Samo član Centralne Izborne Komisije ispred Bošnjacke zajednice decenijama u nazad pripada koaliciji VAKAT, odnosno jednom jedinom članu gospodinu Bajramu Ljatifi, koji su sada naše vlasti još više nagradile te je postao i član Ustavnog suda Kosova.

Gospodo Nova Demokratska Stranka i u Bošnjackoj zajednici konstantno parlamentarna stranka te od predsednika države tražimo da ispravi tu neregluarlost ispoštuje Zakon o opštim izborima odnosno izbor članova iz redova manjinskih zajednica i zaustavi monopol Centralne Izborne Komisije od strane samo jedne političke opcije koja je uzurpirala to mesto te krši Ustav Republike Kosova.

Ništa drugo mi ne zahtevamo nego kao sve ostale zajednice odnosno rotaciju članova, što je naše ustavno pravo kao što to imaju Turci, Romi, Aškalije, Egipćani i ostalih.

Mi smo se i u pismenoj formi obratili predsedniku države uz zakonsko obrazloženje i čekamo odgovor u pismenoj formi.

Takođe, podržavam sve moje kolege poslanike koji su zahtevali da Centralna Izborna Komisija, kao institucija što pre funkcionise i radnih svih zaposlenih koji mesecima unazad ne primaju nikakva finansijska sredstva za svoj rad. Zahvaljujem!

KRYESUESJA: Hvala Emilija! Për replikë fjalën e ka Bahrim Shabani, urdhëroni!

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se potpredsednice!

Ja hoću i da moram objasniti poslanici Redžepi da smo mi kao koalicija VAKAT ubedljivi pobednici na svim parlamentarnim izborima i tamo jasno stoji da je ovaj partija to je politički subjekat koji je pobednik na izborima.

Kada budete pobedili na izborima gospođa Redžepi mislim da će to pravo ovaj pripast i vama. Do tad mislim da nemate pravo ovo da tražite, jer mi smo to naše legitimno ovo pravo iskoristili kao pobednici na parlamentarnim izborima ispred Bošnjacke zajednice, i naravno kao Parlamentarna grupa +6 gde smo dali predlog naših članova koji očekujemo njihovo imenovanje od strane predsednika, gde se nadam da će to jako brzo ovo da se desi.

A što se tiče gospodina Bajrama Ljatifija, naravno on je izabran za sudiju Ustavnog suda, i ako ste lobirati protiv njega i prosto ovde, ja se pitam koga vi predstavljate, da li predstavljate Bošnjake ili koga predstavljate u ovom parlamentu. Hvala!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kundër-replikë, fjalën e ka Emilija Redžepi, urdhëroni!

EMILIJIA REDŽEPI: Gospodine Bahrim Šabani, ne želim sa vama da repliciram, ja želim samo da se poštuje Ustav Republike Kosova, Zakon o opštini izborima, član 139, tačka 6, a ako vi tretirate, to je vaše pravo.

KRYESUESJA: Bahrim, nemaš pravo više, i ti znaš. Fjalën e ka deputeti Dardan Molliqaj, urdhëro!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje për të gjithë deputetët prezentë,

Besoj që çështja e KQZ-së për shumë arsye është me rëndësi për të gjitha partitë politike, edhe për ato që janë në opozitë, edhe ato që janë në pushtet.

Mund të konstatojmë qartë që këtë proces për më shumë se një vit e ka bllokuar ose e ka mbajtur peng Presidenti i Republikës së Kosovës, po ashtu mund të supozojmë mbi motivet dhe arsyet e tij, qofshin ato për të kontrolluar një institucion, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, apo frika e tij nga cilido vendim që ai do të marrë që do të bëjë shkelje kushtetuese.

Të gjithë ju besoj që e dini, Presidenti i Republikës së Kosovës i është drejtuar me pyetje Gjykatës Kushtetuese sa i përket kësaj çështje dhe përgjigjja e Gjykatës Kushtetuese ka qenë që nuk e ka trajtuar fare çështjen.

Dhe, sipas leximit që unë e bëj të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, topi është kthyer te Presidenti i Republikës së Kosovës.

Dhe, në bazë të shkresës që ne e kemi marrë nga Zyra e Presidentit, Presidenti tashmë ka marrë vendim, vendimi është i qartë që gjashtë grupet më të mëdha parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës u ka bërë ftesë ta dërgojnë nga një përfaqësues.

Nëse me këtë vendim e ka bllokuar procesin Presidenti i Republikës së Kosovës, nga ky vendim janë dy parti që janë duke e bllokuar njëanshëm dhe pa arsye procesin.

Cili do të jetë vendimi i Presidentit, të sigurt e kemi që do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese, edhe nëse merret siç ai e ka dërguar, edhe nëse merret 2, 2, 2, pra tri herë nga dy do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese dhe në këtë aspekt është gabim logjik mosdërgimi i përfaqësuesve nga dy partitë e tjera në Kuvendin e Kosovës, sepse këtu janë duke e mbajtur peng një vendim.

Nëse është shkelje që gjashtë grupet më të mëdha parlamentare të kenë nga një përfaqësues në KQZ, pavarësisht që ju i keni dërguar nga një, Gjykata Kushtetuese nuk merr ashi vendimi.

Nëse nuk është shkelje, prapë jemi në rregull, kështu që nuk e di pse po tutni nga kjo çështje, sepse gjithqysh ky çështje do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese. Jeni duke e mbajtur peng. Nëse po doni ta zgjidhni, dërgoni nga një përfaqësues dhe pastaj kur të dekretohen, e çoni në Gjykatën Kushtetuese dhe e këqyrim këtë çështje.

Në këtë aspekt, besoj që jeni duke e penguar procesin, edhe nëse është në dobi tuajën.

Po thirreni në vendimin e Kushtetutës sa i përket themelimit të institucioneve. Nëse e keni lexuar me vëmendje, ai vendim thotë që grupet parlamentare mund të krijohen pasi të themelohen institucionet, themelim i institucioneve, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nënkupton zgjedhja e kryetarit dhe Kryesisë dhe e Qeverisë. Dhe thotë, “pas krijimit të institucioneve të Republikës së Kosovës mund të krijohen grupe të reja parlamentare” dhe mos e lidhni vendimin e Gjykatës Kushtetuese sa i përket formimit të institucioneve me KQZ-në, sepse e ka thënë qartë çka nënkupton themelim i institucioneve, është Kryesia e Kuvendit dhe Qeveria, nuk janë organet e tjera kushtetuese, i kemi edhe disa organe të tjera kushtetuese, të cilat mund të llogariten atëherë që nuk mund të bëhen sipas kësaj formule.

Edhe vlerësimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, edhe të tjerët bëhen nga grupet parlamentare të krijuara pas themelimit. Secili grup parlamentar e çon përfaqësuesin dhe e bën vlerësimin për ata gjyqtarë, jep pikë për ata gjyqtarë, edhe ai është organ kushtetuese.

Ky është një lexim yni, mund të jetë edhe i gabuar, po çka po frikësoheni ta çoni këtë çështje në gjykatë, sikurse Hashim Thaçi që po tutet nga vendimi i gjykatës, edhe ju po frikoheni nga vendimi i gjykatës dhe, në këtë pikë jeni të njëjtë nga frika. PSD është gati ta ketë përfaqësuesin e vet, nëse vendimi i Gjykatës Kushtetuese do të dalë ndryshe, atëherë edhe e shohim.

Mos harroni, nuk ka kuptim për aq sa unë di ta lexoj aspektin juridik dhe kushtetues të këtij vendi, Gjykata Kushtetuese nuk merr dy herë çështje të njëjtë në shqyrtim dhe fakti që Gjykata Kushtetuese e ka refuzuar pyetjen e presidentit.

Po të kishte qenë çështja e qartë, qysh ju po mendoni, atëherë gjykata do të kishte dhënë qysh në pyetjen e parë të Presidentit shpjegimin për këtë çështje.

Unë besoj që tashmë ka material të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese vendimin e Presidentit, sepse është marrë një vendim, partive politike i është dërguar ftesa kujt i takon, tash është çështje e dekretimit dhe me aq sa di unë në Gjykatën Kushtetuese shkojnë vendimet, jo dekretimet.

Pra, ne nuk do të dërgojmë atje pse është dekretuar ky ose ai, po pse është bërë ftesë ndaj këtij subjekti dhe atij subjekti për ndarjen e vendit. presidenca e ka nda vendin e përfaqësuesve në KQZ-së.

Kështu që edhe në ftesën që e keni bërë, edhe në kërkesën që i bëtë rezolutës, PSD-ja e nënshkroi, do ta mbështesë rezolutën e dy partive të tjera që kanë bërë kërkesë për këtë seancë.

Jemi dakord, cilido vendim që të jetë, sepse jemi të interesuar me e dërgua çështjen në Gjykatën Kushtetuese, nëse nuk është në përputhje me interpretimin tonë.

Cilido vendim, unë besoj që e zhbllokon, ose do ta zhbllokoni ju, ose do ta zhbllokojë Hashim Thaçi. Por, në këtë moment që po flasim po aq fajtor për bllokimin e kësaj çështje jeni edhe ju, sikurse Hashim Thaçi, për shkak se çfarëdo vendimi që merret, do të shkojmë në Gjykatën Kushtetuese dhe çështja do të zhbllokohet, o në favorin tuaj, o në favorin tonë, varësisht se cili është vendimi i drejtë.

Jam i bindur tërësisht, siç kam qenë edhe për rastin e nënkryetares së Kuvendit, që interpretimi i Gjykatës Kushtetuese do të jetë në favorin e asaj që ne kemi interpretuar dhe e keni marrë përgjigjen, jo vetëm ju, po secili prej deputetëve që ka pasur mendim tjetër, jo motive, po flas mendim dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka qenë ashtu siç kemi thënë ne si PSD.

Dhe, prapë po e themi që vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht vendimit të Presidentit, do të jetë vendim, i cili do t'i ndajë për gjashtë grupet më të mëdha parlamentare aktuale në ditën kur vendoset për këtë çështje, sepse kjo është e drejta.

Dhe, jashtë saj besoj që duhet pasur vullnet politik. Pse po doni t'i lëni partitë politike pa përfaqësues në KQZ? Çka po ju duhen nga dy përfaqësues, që të mos ketë pastaj komisionar, po duamë ta bëjmë logjikën e njëjtë si e ka pasur PDK-ja kohë pas kohe, që Memlit ia përmenda emrin.

Kështu që bëhuni njerëz që doni t'u jepet rëndësi demokracisë dhe pluralizmit, jo ekskluzivitetit dhe përjashtimit, sepse këtë model e kemi dhe jemi duke luftuar, po jo rrallë në histori, e po duket edhe këtu, duke luftuar e ke përbrendësuar të njëjtën që ke luftuar. Kështu që kujdes nga qasja, edhe unë u bëj thirrje edhe partive të tjera që s'e kanë nënshkruar ose do ta nënshkruajnë më vonë, ta votojmë rezolutën, ta detyrojmë Presidentin të marrë vendim ose nëse Presidenti nuk merr vendim, merrni ju vendim, dërgoni nga një përfaqësues dhe pastaj ecim tutje dhe e dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese. Nuk merr Gjykata Kushtetuese vendim se a i ka dërguar LDK-ja ose Vetëvendosja një apo dy përfaqësues.

Gjykata Kushtetuese merr vendim a është e drejtë t'i ketë dy, dy, dy, apo gjashtë grupet nga një. Kështu që mos e bllokoni procesin, mos u bëni me të njëjtën qasje për motive të tjera dhe për arsye të tjera sikurse Presidenti i Republikës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Për replikë fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari është komplet e papranueshme që bllokimin tendencioz të Thaçit ta shohin si frikësim, siç e tha zoti Molliqaj, tha ndoshta edhe frikësohet. Pra, kjo është një tendencë e pastër për ta amnistuar Thaçin.

Dhe, a e dini pse ky do ta amnistojë Hashim Thaçin, sepse ata po bëjnë pazare bashkë. Unë e përmenda jorastësisht.

Një ditë pra se këta t'i japin mbështetje Hashim Thaçit në këtë idenë e rrezikshme për shkëmbimin territorial, ai u ka dërguar letër të gjitha grupeve parlamentare për dërgim të emrave në KQZ, gjashtë grupeve parlamentare dhe kjo është pazari i pastër, siç kanë bërë edhe me Ligjin për financimin e subjekteve politike, ku tentojnë t'i marrin buxhetin që i takon Lëvizjes Vetëvendosje, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve, siç kanë bërë me nënkryetaren e Kuvendit që e mbajnë pa të drejtë atë pozicion për shkak të pazareve, siç po bëjnë edhe tani. Pikërisht me anëtarin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por ka edhe shumë pazare të tjera që koha do t'i dëshmojë.

Tjetra, ky e ka hall se s'po përfaqësohen në KQZ, përfaqësoheni more në KQZ, si s'përfaqësoheni, po a keni qenë në koalicion me PAN-in. PSD-ja ka qenë në koalicion me PAN-në në zgjedhjet e vitit 2017. Pra, juve ju përfaqëson PDK-ja aktualisht, e pse po mërzi tani. Nëse doni që të përfaqësoheni tamam si PSD tash, që nuk dalloni fare prej të kaluarës, atëherë pritni zgjedhjet, besoj që shumë shpejt do të jenë dhe pastaj në bazë të rezultatit të zgjedhjeve, do të shohim se kush mund të ketë vend në KQZ.

Dhe tjetra, Gjykata Kushtetuese nuk e ka trajtuar, e ka shpallur të papranueshme për shkak se s'ka pasur objekt dhe natyrisht, sipas Kushtetutës Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të shqyrtojë kushtetutshmërinë e dekreteve të Presidentit.

Mund ta lexoni Kushtetutën, e gjeni te palët që kanë të drejtë të kontestojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Për kundër-replikë, fjalën e ka deputeti Dardan Molliqaj, Urdhëroni!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit!

Nuk di çka të them më, dikush që tërë kohën veç ankohet, nuk di çka t'i bëhet, unë jam bukur i lumtur kur e dëgjoj Vetëvendosjen tash se i bie që jemi duke e kontrolluar Presidentin, Kryeministrin, Parlamentin, krejt institucionet dhe jemi faktori kryesor dhe po i shtyjmë agjendat. Në rregull qenka kjo farë pune. Më duket që është më mirë të veprohet, sepse votën e kemi marrë për të vepruar në këtë Kuvend të Kosovës dhe jo veç të ankoheni e të bëni me gisht, më the, i thashë, pazare të tilla, të atilla, se sa të qëndrohet aty edhe vetëm të këqyret seri.

Çka do që dua unë ose çka do që doni ju, nuk varet nga ne, problemi juaj është se nuk keni aftësi të lexoni as realitetin e as dokumentet e këtij vendi. Në vazhdimësi sa herë që shtroni çështje, i hupni, sepse nuk dini...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Zonja Albulena, edhe ju e dini që nuk keni të drejtë të kërkonit fjalën edhe një herë.

Për replikë fjalën e ka shefi i Grupit të PDK-së, zoti Memli Krasniqi, urdhëroni!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të them të drejtën, për dallim prej disa prej kolegëve këtu, që s'po e di a janë përnjëmend ekspertë prominentë të së Drejtës Kushtetuese, qysh po i japin të drejtë vetvetes të shprehin të vërtetën finale, unë rezervohem, nuk jam një prej tyre.

Por gjithsesi dua ta risqaroj edhe një herë, më shumë për opinionin publik, qëndrimin e PDK-së.

Jemi e vetmja parti që bash nuk kemi asnjë kushtimisht "kalë në garë", cilido prej opsioneve që ndodh, për PDK-në është njëjtë, qoftë nëse shkohet 2, 2, 2, PDK-ja e ka një përfaqësues në KQZ,

qoftë nëse shkojnë me gjashtë opsione, PDK-ja e ka një përfaqësues në KQZ. Neve vetëm na intereson zhblllokimi i KQZ-së, sepse siç e dini, e kemi një deputet më pak edhe si PDK, edhe si koalicion për shkak të bllokadës së KQZ-së, por jo vetëm për këtë, por edhe për arsye të tjera që e kanë pamundësuar funksionimin efikas të të gjitha partive politike për shkak të kësaj mungese. Pra, PDK kërkon vetëm funksionalizmin sa më parë. Inatet personale që mund t'i kenë partitë që kanë "kalë në garë", që u takon një ose s'u takon asnjë, që u takojnë dy ose u takon një, në vlerësimet e tyre të ekspertëve, qysh i quajta, për neve janë irelevante.

Arsyeja pse ne nuk e votojmë këtë rezolutë ka të bëjë me parimin e mosndërhyrjes në pushtetet e ndara, vetëm për këtë. Mund t'ua nënshkruaj sot, pa asnjë problem, meqenëse u bë e qartë edhe prej përfaqësuesit të PSD-së, zotit Molliqaj, që e paska nënshkruar, pa asnjë problem mund ta nënshkruajmë, por besoj që e thyejmë parimin e ndërhyrjes nga një pushtet në një pushtet tjetër. Por, po e qartësoj edhe një herë, për neve është me rëndësi Presidenti të marrë një vendim. Këtu u tha që do të sfidohet në Gjykatën Kushtetuese, e unë e kuptova edhe një send, krejt çka janë duke folur këto partitë opozitare për zgjedhje janë të pasinqertë, janë hajgarexhinj, kurrjë tjetër, sepse nëse sfidohet në Gjykatën Kushtetuese, s'ka KQZ, rrjedhimisht s'mund të ketë as zgjedhje.

KRYESUESJA: Faleminderit! Për kundër-replikë fjalën e ka deputeti Dardan Molliqaj, urdhëroni!

DARDAN MOLLIQAJ: Shumë mirë që PDK-ja e ka këtë pozicion, besoj që është mirë të ushtrohet ndikimi i vet që e ka te Presidenti i Republikës së Kosovës që të marrë një vendim. Unë po them prapë, cilindo vendim që ai e merr, unë e kam të qartë, Memli, që do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese, prej cilësdo palë, edhe ai do të jetë arbitri dhe kështu zhblllokohet, për këtë arsye i bëra thirrje jo vetëm Presidentit, por edhe partive të tjera të marrin vendimin. Për mua Presidenti ka marrë vendim.

Ndërsa, janë disa parti politike këtu që një herë i kundërshtojnë ato vendime, pastaj thirren këtu, vendimin për themelimin e institucioneve e kanë kundërshtuar dhe s'janë pajtuar me të, tash thirren në të dhe e kanë futur në tekst të rezolutës. Vendimin për nënkryetar të Kuvendit një herë e kanë refuzuar, tani janë thirrur në të, tash e mohojnë. Është hipokrizi, sepse kur më konvenon, në rregull është, i njëjti vendim kur s'më konvenon, nuk është në rregull. Nuk mund të ndërtohen institucionet e Republikës qysh të konvenojnë ty, kjo kallëzon për mendësinë e pazareve. Mendësi të pazareve nuk kanë partitë, të cilat i pranojnë vendimet edhe kur...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Veç njeri më i pafat se unë, bash ti erdhe kur desha unë të flas, tash ti ma ndal fjalën.

Së pari, desha të vazhdoj një mendim të Dardan Molliqajt. Tha që ka njerëz, të cilët nuk dinë të lexojnë, ka njerëz që dinë të lexojnë, po s' dinë të kuptojnë, ka njerëz që vetëm dëgjojnë e kurrjë s'kuptojnë dhe një filozof thotë “unë jam përgjegjës për atë që e them, për atë që e shkruaj, por jo për atë që ti e kupton dhe jo për mënyrën qysh ti e interpreton”. Me keqardhje të madhe e them me tërë respektin që e kam për Albulenën, si njeri, si familje, që sot më keni zhgënjyer me mënyrën e komunikimit, ngase ju jeni paraqitës të kësaj rezolute, Vetëvendosja.

Ju e keni thirrur seancën e jashtëzakonshme dhe mbi bazën e kësaj mënyra e komunikimit me përfaqësues të partive të tjera, qoftë të PDK-së, qoftë të Nismës, të PSD-së, nënkupton që ju nuk keni ardhur këtu ta nënshkruani këtë rezolutë. Unë në mënyrë absolute kam pasur vendim për nënshkrimin e kësaj rezolute dhe më vjen shumë keq që miku im i vjetër dhe i shumëvujturi nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë, Sami Kurteshi, në momentin kur erdhi dhe na u drejtua për nënshkrimin e rezolutës, pikërisht për shkak të fyerjeve dhe të këtyre denigrimeve as 6+, as Nisma, domethënë nuk pranoi të nënshkruhet rezoluta, një rezolutë që unë mendoj që është e rëndësishme, e tha edhe Memli që është e rëndësishme, e thanë të gjithë që është e rëndësishme, edhe LDK-ja, sepse jemi në bllokadë.

Po e marr një krahasim, që të jem i qartë përpara atyre katundarëve të mi që na dëgjojnë përmes radio televizionit, për publikun. Jemi në të njëjtën situatë siç është Republika e Shqipërisë, imagjinoni sikur Shqipëria të mos kishte KQZ, çka do të ndodhte? E njëjta situatë, domethënë ne vetëm edhe dy muaj, në qoftë se nuk koordinohet KQZ-ja, edhe dy muaj do të bëhet hataja, a është kështu Memli, a jo? Po ashtu, 2 muaj e tri ditë, sepse kryetarët e komunave kanë dhënë dorëheqje, KQZ-ja nuk është funksionale, deputetët, të cilët po presin dhe asamblistët nëpër komuna nuk po mund të hyjnë për shkak të mosfunksionimit të KQZ-së. Tani shihet që Presidenti i Kosovës na ka gjuajtur në ‘penallti’ dhe gëzimi më i madh i tij është kur bën ‘penallti’. Dihet që ai sa herë të bën ‘penallti’, gjithmonë jep gola.

Unë i kam thënë LDK-së, se po ia përsëris edhe një herë, që krejt problemet kanë ardhur se kur e kanë votuar Thaçin për President këta kanë menduar që ai është Atifetja, nuk ka qenë Atifete Jahjaga Hashim Thaçi, prandaj krejt rrotullimi i këtyre tabelave ka ardhur si rezultat i qëndrimeve të tij që ai e di fort mirë që duke e bllokuar procesin e KQZ-së, institucionin më të rëndësishëm, na sjell ne deputetëve të Parlamentit të Kosovës në një debat që nuk do të duhej të ishte. Ne do të duhej të mblidhemi këtu, për shembull, edhe të debatoni për ato shpenzimet kolosale që i kanë bërë qeveritë e kaluara pa kurrfarë plani, pa kurrfarë projekti në Bruksel, që tejkalojnë diku 1 milion e gjysmë euro të taksapaguesve të Kosovës. Ose, ishte dashur ne si deputetë të këtij Parlamenti të merremi me hartimin e një Rregulloreje të re të Parlamentit të Kosovës. Ne s' kemi Rregullore të Parlamentit, ne, për shembull, për fatin e keq thërrasim seanca

dhe unë sot i kam parë disa deputetë në orën 5 minuta para 10-ve, për shembull, unë jam ngritur, nuk po i përmend cilët, por kam parë deputetë, kolegë të mi që fiksojnë në orën 10:00 janë ulur të pinë kafe nëpër sheshin “Nënë Tereza” dhe vijnë në seancë në 11:00, 11:30, 12:00.

Kryesia e Kuvendit i fillon seancat kur të dojë, domethënë në 10:00 e kemi ne, në 12:00 e fillojnë, të mos jetë turpi që jemi përgjegjës përpara qytetarëve të Kosovës, unë kisha ardhur, isha nënshkruar dhe kisha ikur në shtëpi. Me shumë të drejtë, me shumë përgjegjësi morale e njerëzore, edhe sot u thashë gazetarëve që janë atje, pashë Zotin, u thashë, a më tregoni çka keni për të raportuar prej seanceve, pse nuk shkoni me kamera nëpër kafe të Prishtinës e t'i incizoni deputetët që në orën 10:00 rrinë e pinë kafe.

Janë 1 milion tema të tjera, për të cilat ne mund të merremi. Unë po them veç diçka, e nderuar Albulenë, kjo 2+2+2, sa të është gjallë Presidenti Thaçi nuk e nënshkruan, e tash, këtu do të dal, te qarja, kisha pasur dëshirë, në qoftë se ju mendoni që Presidenti nuk ka qare, hajde vëlla i bëjmë 81 vota dhe e rrëzojmë Presidentin. A mund ta rrëzojmë? Sille një letër, unë tash e nënshkruaj, jo më fal, unë nuk flas në emrin e Nismës, unë as nuk jam anëtar i Nismës, jam krenar që përmes Nismës jam deputet i Parlamentit të Kosovës. Absolutisht po!

Unë i përfaqësoj votuesit e PDK-së, AAK-së dhe të Nismës, por unë nuk e përfaqësoj Nismën, por si deputet i Parlamentit të Kosovës, kur të doni jua jap votën, edhe për rrëzimin e Qeverisë në shtator, por jo për taksë. Hajde ulemi, merremi vesh, themi po shkojmë në zgjedhje në shtator, e bëjmë një marrëveshje politike dhe deri në shtator e zhbllokojmë Kuvendin e Republikës së Kosovës, aprovojnë disa ligje, e bëjmë një Rregullore të re, i bëjmë disa punë të mira.

KRYESUESI: Milaim, a po hyn në temë?

MILAIM ZEKA: Më fal, a po e sheh, veç mua më dëgjon kryesuesi, e tash të dal te tema, te KQZ-ja, do të thotë, kryesues veç s'ke qenë këtu, se kush në temë s'ka qenë, as s'ka folur, veç çka ke që veç mua më dëgjon nuk e di. A kam folur mirë? Hiç, veç mua më dëgjon ky, edhe atje kur është, më lëshon në televizor çka po flas, nejse.

Sidoqoftë i bëj thirrje Presidentit që ta zhbllokojë KQZ-në, edhe Albulenë, hatri yt do ta nënshkruaj, e ndërrova mendimin.

KRYESUESI: Milaim, a bën replikë? Zoti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë,

KRYESUESI: Më fal, Driton, veç një sekondë, replikë ka Memli.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Unë edhe përfaqësuesi i PDK-së, zoti Reçica, edhe ne e shprehëm qëndrimin tonë dhe besoj që s'ka nevojë të përsëritim që për neve është me rëndësi zhbllokimi i KQZ-së sa më herët. Por, e vërteta është që janë disa tema, të cilat i kemi obligim si institucione në përgjithësi, Qeveria në radhë të parë t'i trajtojë pak më me seriozitet.

Çështja e katër komunave në Veri, të cilat realisht nuk kanë kryetar, ne mund të themi që kanë kryetar, se s'ua pranojmë atyre ato letrat e dorëheqjes, po aty kryetar nuk ka, është një problem në veti. E dyta, u tha edhe nga deputetja Kusari Lila qëndron, në momentin kur kuvendet komunale nuk e mbajnë asnjë mbledhje për një periudhë gjashtëmuajore, neve na duhet të shkojmë në zgjedhje. Nuk është përgjegjësi e drejtpërdrejtë as e Kryeministrit, siç u mundua të interpretohet, as e Presidentit, por është përgjegjësi e të gjithëve.

Po flasim për Veriun e Mitrovicës, për një situatë ku ne s'mund t'i shpallim zgjedhjet, edhe nëse i shpallim s'mund t'i mbajmë. Kështu që këto inatet personale që mund të ketë Vetëvendosja me PSD-në, ose LDK-ja me këdo tjetër, kishte qenë mirë për një moment t'i ndalim dhe t'i mendojmë situatat, të cilat nuk e rrezikojnë Qeverinë, Presidentin, Kuvendin, por rrezikojnë funksionimin unitar të Republikës së Kosovës dhe që mund të na ndodhin dy muaj prej tash ose 3 muaj prej tash. Kërkesa ime është hajde të gjejmë një mundësi t'i japim rrugë zhbllokimi situatës, pra le ta çojnë secila, edhe LDK-ja, Vetëvendosja nga një emër, siç ka ardhur kërkesa prej Presidentit, nëse kjo është një rrugëdalje, pastaj le ta sfidojnë vendimin në Gjykatë Kushtetuese, nëse vërtet besojnë që kanë të drejtë. Por, situata në të cilën jemi, ku kanë qëndruar të barrikaduar, nuk marrin asnjë hap, nuk e zhbllokon KQZ-në, Presidenti s'mund të marrë vendim dhe ne s'mund të ecim përpara, kjo është keq për vendin.

KRYESUESI: Faleminderit! Driton, vazhdoje fjalën!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Unë mendoj që është prej rasteve të rralla, të mos them i vetmi, ku Kuvendi diskuton për t'ia kujtuar dikujt detyrat e tij. Domethënë, ne sot po diskutojmë pse Presidenti që një vit nuk e ushtron funksionin e tij për një tematikë që është funksionalizimi i KQZ-së.

E kam përshtypjen sikur debati po zhvillohet në atë formë sikur çështja e mandatit të dikujt është çështje e vullnetit a dëshiron ai ta zbatojë apo jo një kompetencë kushtetuese. Mandati i Presidentit nuk është i dëshirueshëm në situata të caktuara, çka do ai të bëjë, çka s'do të bëjë. Mandati politik dhe kushtetues i atij institucioni është që t'i kryejë punët e veta kushtetuese dhe nëse nuk i kryen, atëherë përgjegjësia duhet të jetë kushtetuese. Po çka jemi në situatë ne? Ne jemi në situatë ku ai i cili do duhej të ishte garant i funksionimit kushtetues të institucioneve, është rreziku kryesor për këto institucione. Domethënë, Presidenti i vendit, tashmë duke mos e funksionalizuar KQZ-në si duhet, po e cenon rëndë institucionin kushtetues, KQZ-në, e para, po

e cenon rëndë të drejtën e disa asamblistëve, të cilët janë zgjedhur dhe kanë të drejtë ta realizojnë mandatin e tyre, po e cenon rëndë të drejtën e disa deputetëve që tash po presin në rend për të ardhur në Kuvend, për ta realizuar misionin e tyre për çka kanë marrë votë, por nuk arrijnë ta realizojnë atë dhe tjetra është që po cenon rëndë të drejtën e partive politike për t'i gëzuar buxhetin nga paratë e shtetit për të funksionuar ato parti. Veç LDK-ja është muaji i tretë që ka mbi 50 punëtorë që s'po arrin t'i paguajë punëtorët, të cilët janë staf mbështetës qoftë i Grupit tonë Parlamentar, qoftë edhe i strukturave tona partiake.

Dhe ne po e mohojmë të drejtën e personave për ta realizuar pagën e tyre, si të drejtën më elementare dhe kush po e bën këtë? Po e bën Presidenti i vendit. Unë po e shoh këtu, këtu ne dallojmë vetëm një çështje, besoj unë, tek interpretimi ose tendenca për interpretim politik të një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese dhe ku është dallimi, mendoj unë, dallimi është përpjekja për ta maksimalizuar kapjen e shtetit edhe në këtë institucion. Mua s'më ka pëlqyer aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese kur e ka dhënë në atë kohë që e ka thënë se Grupi Parlamentar duhet të lidhet me rezultatin e zgjedhjeve. Mendimi im është që nuk është kështu. Grupi parlamentar është krejtësisht diçka tjetër në krahasim me rezultatin e zgjedhjeve, por Gjykata Kushtetuese kështu ka thënë dhe tash nëse ne e njohim këtë interpretim vetëm kur konstituohen institucionet dhe më pas kjo nuk vlen, po kjo është krejtësisht qasje e gabueshme. Grupet parlamentare, sipas këtij interpretimi kanë të drejtë të realizojnë të drejtat e tyre veç në përfaqësim në komisione parlamentare më pas, por jo në organe kushtetuese.

“Përfaqësimi në organe kushtetuese lidhet me rezultatin e zgjedhjeve”, kështu ka thënë KQZ-ja, kështu ka thënë Gjykata Kushtetuese, jo ne, është e drejtë apo jo, ky është interpretimi i tyre. Koalicioni PAN është i vetmi subjekt i certifikuar në KQZ dhe është KQZ-ja nuk njih subjekt tjetër, edhe në ndarjen e fondeve, edhe në përfaqësim në organet e tjera kushtetuese dhe shkoni sot në KQZ, shihni kush janë subjekte të certifikuara, të cilat realizojnë të drejta politike dhe jo vetëm politike në Kuvend të Kosovës, është PAN-i, Lëvizja Vetëvendosje, LDK dhe më pas vijnë partitë e tjera politike. Por tendenca këtu që KQZ-ja të shndërrohet në një institucion që sa herë themelohen grupe të reja parlamentare këtu, të shkojnë në përfaqësim atje, kjo mund të jetë një logjikë demokratike, tendencave sa më plurale, por kështu s'ka thënë Gjykata Kushtetuese dhe ne tash jemi peng i këtij aktgjykimi dhe nëse jemi peng i këtij aktgjykimi, ne duhet të respektojmë këtë, nuk është çështje dëshire a dëshiron PDK-ja, Nisma, AAK-ja të dërgojnë nga një kandidat, PAN-i, keni zgjedhur ju të jeni bashkë, dy kandidatë duhet t'i keni atje, sepse kështu ka thënë Gjykata Kushtetuese.

Unë po ndihem keq që kemi filluar Kuvendin e Kosovës ta shndërrojmë në njëfarë institucioni përgjërues, po e lutim Presidentin që t'i kryejë punët e veta. Domethënë, jemi duke e devalvuar këtë institucion, ne s'mundemi kështu, nuk guxojmë ta lëshojmë deri në këtë nivel sa që të themi: “Të lutem President, ushtroje bre mandatin tënd”, nuk guxojmë kështu, besomëni që jemi duke rrëshqitur prej misionit tonë kryesor që e kemi. Dhe, cili është ai, meqenëse ne po e shohim që

presidenti po paraqitet pengesë për funksionimin kushtetues të institucioneve të tjera, të provojmë të gjejmë mënyra kushtetuese ta izolojmë këtë President, sepse rreziku po na vjen nga ky President. E nuk mund të themi kështu hajde, shihe, po i dërgojmë një herë anëtarët, ta shohim çfarë po bën Presidenti dhe më pas e kontestojmë në Gjykatë Kushtetuese.

Jo, jo, ai duhet të veprojë vetë, më pas ne mund të kontestojmë ose jo vendimin e tij. Nuk është, po e them përsëri, po kthehem te çështja fillestare imja, ushtrimi i mandatit kushtetues nuk është dëshirë, është detyrim, është mandat dhe si i tillë kështu duhet ta shohim. Por, të provohet tash që për disa duket sikur janë pazare krejtësisht të natyrave tjera, për t'i çoroditur institucionet kushtetuese, unë besoj që po vendosni një precedent, të cilët dikur do të qeshin ata të cilët do të merren me historikun e parlamentarizmit, sistemit kushtetues në Kosovë dhe sistemit politik se si ka funksionuar. Të vendosim parime, të cilat respektojmë akte, respektojmë vendime kushtetuese, nëse s'na pëlqejnë, i ndërrojmë ato, por jo pazaret politike t'i shndërrojmë në normë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, replikë!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Meqë ma mori mendja, apo kështu e kuptova që Dritoni iu referua fjalës sime, desha të marr fjalën edhe të sqarohem së paku qysh e shoh unë. Faleminderit, Driton, deri në momentin e pazareve, ke qenë jashtëzakonisht korrekt dhe në këtë pjesë do të polemizoj, në këtë pjesë do t'ia lë kohës, të shihet se kush me kë ka bërë pazare dhe për çka kanë bërë pazare, koha do ta vërtetojë, por do të flas për kërkesën tjetër.

Pajtohem plotësisht me ty, ajo që unë e thashë është se unë kështu po e shoh, Nisma kështu po e sheh që në momentin kur Presidenti merr vendim për të kërkuar nga grupet parlamentare emërimin e kandidatëve, nuk është më në kompetencë të grupeve t'i thuhet "ti nuk e ke interpretuar drejt të drejtën tënde kushtetuese". Pra, ajo që ne po bëjmë këtu, në fakt ju VV dhe LDK është që po i thoni Presidentit "nuk ta çojmë një emër, po veç dy dhe pikë".

Pra, ju po e merrni kompetencën e interpretimit të Kushtetutës, jo ne, unë po them është e mundur që është ashtu siç po thoni, por unë njëkohësisht besoj që kjo çështje nuk është përfundimisht e interpretuar nga Gjykata Kushtetuese dhe meqë Presidenti ka kërkuar nga një emër, dërgojeni një emër, pra ai po ushtron funksionin e vet, ju po i thoni "jo, nuk je duke e ushtruar qysh po na pëlqen neve, apo qysh ne po e interpretojmë vendimin, aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese". Tash, për t'u zhblllokuar kjo, duhet të veproni ju, të gjitha grupet parlamentare t'ia dërgoni nga një. Sikur ai të kishte kërkuar nga ju nga dy emra, ju do të ia kishit dërguar, ne do të ishim ankuar. Tash meqë ka kërkuar nga një, dërgojeni dhe ankojuni, për të dhënë një sqarim përfundimtar Gjykata Kushtetuese rreth kësaj çështjeje. Mund të keni ju të

drejtë, mund të mos keni të drejtë në këtë interpretim, nuk absolutizova aspak, kjo është ajo që desha të them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë zoti Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Zoti Sherifi, faleminderit!

Në fakt, besoj e kupton edhe ti që unë s'e kisha me juve për çështjen e pazareve, e dini për kënd e kisha, besoj. E dyta, ka të bëjë me atë që ju po thoni, po mendon Nisma, po mendon LDK-ja, Vetëvendosje, unë mendoj që institucionet, të cilat do duhej të ishin garant funksionimit kushtetues të institucioneve s'do ta merrnin fare relevant mendimin tuaj, timin ose të një subjekti të caktuar politik. Ata do të duhej të merrnin për bazë dokumente të institucioneve kushtetuese, po them a është i drejtë a s'është i drejtë aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, është çështje, temë tjetër, po them e kemi një aktgjykim dhe si të tillë ashtu duhet të veprojë organi tjetër, në këtë rast Presidenti, për të kryer mandatin e tij, sepse po them, grupet e reja parlamentare që themelohen për të realizuar të drejtat e tyre brenda Kuvendit të Kosovës në komisione parlamentare, por jo në organe kushtetuese. Në organe kushtetuese Gjykata Kushtetuese ka thënë që rezultati i zgjedhjeve është referenti kryesor dhe asgjë tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, një minutë!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues, për mirëkuptimin!

Për hir të informimit të drejtë, Presidenti fillimisht ka kërkuar nominime nga ne. I kemi dërguar dy nominime dhe mandej e ka kthyer shkresën e tij, ka thënë njëri nga nominimet vlerësojmë që nuk i përmbush kushtet e ligjit për zgjedhje të përgjithshme, pra ka kërkuar dy nominime, sepse e ka pasur të qartë se çka është grupi parlamentar, siç është definuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

E pas kësaj, mandej e ka dërguar çështjen në Gjykatë Kushtetuese për interpretim, e ka kthyer Gjykata Kushtetuese si kërkesë të papranueshme, mandej e ka kërkuar një nominim. Ne kemi dërguar dy nominime, por le të themi që nuk po i respekton ato dy nominime, le t'i emërojë presidenti nga Grupi Parlamentar i PDK-së, i AAK-së, Nismës, PSD-së dhe partive të tjera, le t'i lërë të LDK-së dhe të Vetëvendosjes një herë, duke qenë se ia kanë dërguar dy nominime, e jo një siç ka kërkuar ai, dhe mandej le të zhblllokohet kjo çështje. Pra, nuk janë duke e bllokuar LDK-ja dhe Vetëvendosja këtë çështje, por është Presidenti...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Gjatë debatit të sotëm të gjithë diskutuesit u pajtuan se KQZ-ja është një institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe pa të nuk bën të jetë shteti. Po ashtu, të gjithë ata që diskutuan sot fjalën e tyre e përfunduan me kërkesën që Presidenti sa më parë t'i emërojë anëtarët e KQZ-së, e që do të thotë që ai nuk e ka kryer një detyrë që është detyrë kushtetuese e tij dhe kjo e nxjerr Presidentin si në gabim.

Se KQZ është e rëndësishme u fol nga të gjithë ata që folën deri tash dhe të gjitha ato që u thanë qëndrojnë. Nuk u përmend një çështje e cila konsideroj se po ashtu është shumë e rëndësishme, pastrimi i listave të votuesve që është detyrë e KQZ-së dhe që është në një gjendje të palakmueshme pasi që në ato lista ende gjenden emrat t të vdekurve të cilët kanë vdekur edhe më shumë se një dekadë. Prandaj, edhe ky është një obligim që nuk po kryhet për shkak të neglizhencës ose kryeneçësisë, ose s'e di çka cila është arsye e Presidentit që nuk po e kryen këtë punë.

Më bënë përshtypje dy konstatime të folësve të mëhershëm. Njëra ishte konstatimi se kërkesa që të veprohet në përputhje me Kushtetutën të cilësohet si ndërhyrje në institucionin e pavarur, në KQZ. Vërtet është një konstatim që nuk e kap logjika e shëndosh, siç nuk e kuptoj sesi mund të jetë e papranueshme rezoluta që kërkon respektimin e Kushtetutës dhe Ligjit për zgjedhje. Këto dy çështje mendoj se do të duhej patjetër të rishqyrtohen edhe ata që kanë këso qëndrimi, ta ndryshojnë qëndrimin.

Kjo që po ndodh nga ana e Presidentit është në përputhje me logjikën nëse diçka nuk mund të kontrollosh, ose shuaje ose bllokoje, e që shkon me logjikën që është shumë e përhapur këtu në Kosovë e kapjes së shtetit dhe këto përpëlitje besoj të fundit duhet që përmes institucioneve siç është Gjykata Kushtetuese dhe gjykatat e tjera, të hiqet njëherë e përgjithmonë.

Kisha komentuar edhe dy-tri çështje të cilat për mua janë absolutisht të papranueshme. Ne të gjithë e dimë që çdo institucion që i ka mbi 50 për qind të anëtarëve, është funksional. Prandaj, konstatimi i deputetit Dardan Molliqaj se opozita po e bllokuaka KQZ-në është krejt e paqëndrueshme. Nëse i ka gjashtë subjekte, i ka kërkuar gjashtë veta, le t'i emërojë katër, pastaj funksionalizohet KQZ-ja dhe partitë opozitare, edhe nëse duan, nuk mund ta pengojnë, e pastaj procedurat e tjera i vazhdojnë ata, ashtu siç mendojnë opozita e çon lëndën në Kushtetuese.

Edhe një çështje që ishte krejt e papranueshme nga ana e z. Molliqaj që ishte krejt joparimore, pra ishte ajo që kur flitej për KQZ-në kërkohej që të merrej parasysh situata aktuale, po më herët kur flitej për përfaqësimin në kryesinë e Kuvendit, atëherë kërkohej që të merrej parasysh rezultati i zgjedhjeve. Nuk të takojnë të dyja. Ose duhet të përcaktohesh dhe të angazhohesh për çështjen, për rezultatin e zgjedhjeve, ose për situatën aktuale, po t'i kërkoesh të dyja do të thotë të jesh joparimor.

Sa i përket kësaj kërkesë që opozita t'i dërgojë dy përfaqësues, ashtu siç ka kërkuar Presidenti, dëshiroj vetëm t'i përkujtoj të gjithë ata që e kanë një kërkesë të tillë se kërkesat e kundërligjshme, as nuk duhet dhe as nuk bën të zbatohen. Zbatimi i kërkesave të kundërligjshme janë përgjegjësi për ata që i zbatojnë dhe për ata mund të përgjigjen para ligjit. Prandaj, një kërkesë e tillë që konsiderohet e kundërligjshme nuk duhet të zbatohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaliaj, urdhëro!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse i vonuar ky debat lidhur me mundësinë e zhblokimit të KQZ-së, po tash jemi në një hap të ri, për shkak se shumë është biseduar dhe është deklaruar edhe në publik, edhe në media, nga partitë e ndryshme politike, grupet parlamentare, tani jemi në një situatë të re, për shkak se Presidenti i Republikës veç iu ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një shkresë, sepse atë shkresë që ia ka drejtuar janë kryesisht kërkesa të subjekteve politike. Po në rastin konkret, ne nuk jemi duke shkuar drejt zhblokimit të këtij problemi, po jemi duke e bllokuar edhe më shumë. Gjithçka tani pasi kthimit të përgjigjes nga Gjykata Kushtetuese është në dorën e Presidentit të veprorë. Nuk mund të krijohet ndonjë precedent i ri, sepse secili grup parlamentar të ketë përfaqësues atje.

Ne e dimë mirë që secili subjekt, duke filluar nga koalicioni qeverisës dhe partitë opozitare, secila mundemi t'i bëjmë pres dy e tri deri pesë grupe parlamentare, nëse duam të bllokojmë. Vetëm PAN-i mund të krijojë pesë grupe parlamentare sot, për të thënë se ne duam t'i çojmë pesë përfaqësues. Por, kryesisht duhet t'i përmbahemi ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë që ka qenë deri tash, edhe ka qenë praktikë. Praktika është më se e nevojshme të zhvillohet edhe në rastin konkret, e jo të krijojmë një precedent të ri që edhe të ndryshojnë anëtarët e KQZ-së jashtë procesit zgjedhor ndërmjet dy palë zgjedhjeve. Është në dorën e Presidentit të vendosë, është e drejtë edhe e secilit subjekt parlamentar që është parti parlamentare, po ne e dimë që ka subjekte që janë krijuar pas krijimit të institucioneve tash dhe nuk di a janë të regjistruara në KQZ, për shkak se KQZ-ja nuk është funksionale.

U fol për mjetet dhe për të gjitha të tjerat, por në rastin tonë është më se e rëndësishme që të reflektojmë Presidenti. S'po di, s'e kam parë tekstin e rezolutës, mirëpo ne nuk mund të dalim jashtë ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë. Pjesa tjetër është se nëse partitë parlamentare ose partitë politike që përfaqësohen në Kuvend, nëse nuk iu pëlqen ndonjë pjesë, nuk është e domosdoshme që t'i kemi edhe dy të tretat e pakicave lidhur me ndryshimin e ligjit, edhe ndonjë pjesë të Kushtetutës. Mund të merremi vesh këtu, edhe ta ndryshojmë edhe atë pjesë të ligjit edhe të Kushtetutës për t'i dhënë kahe tjetër. Jemi duke biseduar që pa marrëveshje politike, edhe domosdoshmërisht është kjo kërkesë kaq e përngutshme, edhe e jashtëzakonshme e subjekteve politike, mund të ulemi dhe të merremi vesh dhe e fusim në procedim plotësim-ndryshimi, si në

ligj, si në Kushtetutë, edhe rregullohet kjo çështje. Është detyrë ekskluzive kjo e jona. Po në rastin konkret duhet tani të reflektojë Presidenti dhe të mos krijohet ndonjë precedent i ri që nuk ka ndodhur deri më tash.

Deri në procesin e ardhshëm zgjedhor, sepse edhe pas atyre zgjedhjeve që do të mbahen, atëherë do të kemi probleme të tilla sesi do të përfaqësohen subjektet politike në KQZ. Kaq kisha, është e rregulluar mirë me Kushtetutë, edhe me ligj. Mos të krijojmë ndonjë precedent të ri. Le të reflektojë Presidenti. Është e drejtë edhe ankesa, por kryesisht këto ankesa në Gjykatën Kushtetuese nuk kanë rezultuar pozitivisht deri tash, po pas pesë vitesh po më vjen mirë që po thonë po pranohen edhe nga ato pari që i kanë kundërshtuar, kështu që jemi në kohën e duhur. Faleminderit, kryesues! Respekt, kolegë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Doruntinë Maloku, urdhëro!

DORUNTINË MALOKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Bunjamin Hoti është një i ri nga Podujeva, i cili për shkak të aktiviteteve të tij me të rinjtë dhe aktivizmit të tij qytetar, ka fituar besimin e qytetarëve në zgjedhjet lokal për t'i përfaqësuar ata në Kuvendin Komuna. Bunjamini vazhdon me aktivitetin e tij të përditshëm me të rinjtë si kryetar i Forumit të Rinisë së LDK-së në Podujevë, por jo në institucionin ku ai do të duhej të punonte që 8 muaj, ku do t'i adresonte idetë e të rinjve llapjanë, nevojat e tyre si dhe projektet që kanë të bëjnë me avancimin e rinisë në atë rajon, në bazë të besimit të marrë me votë.

Si Bunjamini në mbarë Kosovën janë dhjetëra asamblistë, të cilët nuk po arrijnë ta ushtrojnë funksionin e tyre, për shkak se Presidenti Thaçi kësaj here i është tekur që t'u bëjë problem partive opozitare nëpërmjet bllokimit të KQZ-së dhe kështu ka bllokuar përveç tjerash edhe shumë vendime të kuvendeve komunale, duke pamundësuar certifikimin e asamblistëve, edhe pse kjo është një padrejtësi më vete, pasi zgjedhjet janë të certifikuara dhe kjo është një shkelje e të drejtave themelore.

Nga ana tjetër, qindra punëtorë të partive politike nuk marrin paga që disa muaj, pasi në mungesë të vendimmarrjes në KQZ, nuk është alokuar as buxheti për partitë parlamentare nga fondi i demokratizimit. Presidenti i Kosovës fillimisht duke e zvarritur me qëllim emërimin e anëtarëve të rinj të KQZ-së që prej zgjedhjeve të qershorit 2016, pastaj duke e referuar çështjen pranë Gjykatës me një vit vonesë, kinse për të kërkuar interpretim lidhur me përbërjen e KQZ-së, u tha këtu disa herë që ka vepruar në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës, sipas të cilën ai duhet të garantojë funksionimin e rregullt të organeve kushtetuese të Republikë së Kosovës.]

Sjellja e këtillë tendencioze e Presidentit Thaçi përbën një sulm të drejtpërdrejtë në sistemin parlamentar dhe demokratik të Kosovës dhe e shkel të drejtën themelore të besimit që qytetarët ua kanë dhënë të zgjedhurve të tyre me votë. Por kjo nuk është risi, sepse Presidenti ka herë ka filluar me mbështetjen e akteve dhe të veprimeve që janë në kundërshtim të plotës me aktin tonë më të lartë juridik.

Funksionimi i KQZ-së duhet të zhblokohet sa më shpejt dhe të ndaloheq presioni që po u bëhet partive opozitare nëpërmjet zvarritjes së këtij procesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot në seancë plenare jemi duke debatuar një çështje që konsideroj është e rëndësishme, edhe pse nuk është kompetencë e jona. Mendoj që pushtetet në këtë vend janë të ndara dhe secili institucion duhet ta kryejë punën e vet në harmonizim me Kushtetutën e vendit.

Seanca e thirrur sot nga opozita lidhur me KQZ-në, për mendimin tim është direkt interferim në institucionet e pavarura kushtetuese. Për mendimin tim, KQZ-ja ka fajin e vet për bllokimin e KQZ-së. Kur e them e ka fajin e vet, lidhem me të kaluarën e KQZ-së. Kemi shumë argumente ligjore se puna e KQZ-së nuk është dashur të ndërpritet. Nuk kemi asnjë dekret të Presidentit për pezullim apo ndërprerje të mandatit të anëtarëve të KQZ-së. Ju e dini besoj të gjithë, ju që jeni marrë me procese zgjedhore, se pas zgjedhjeve të vitit 2010, nuk është rimanduar KQZ-ja, ka vazhduar punën deri në qershor të vitit 2014, me të njëjtën gjendje ligjore të cilën e kemi edhe ne sot. Do të thotë edhe kushtetuese, edhe ligjore. KQZ-ja ka mbajtur dy palë zgjedhje në nëntor të vitit 2013, zgjedhjet lokale dhe në qershor të vitit 2014 zgjedhjet e përgjithshme.

Në të njëjtën situatë të ngjashme në atë kohë KQZ-ja ka prodhuar efektet juridike, duke legjitimuar institucionet e dala nga dy palë zgjedhjet e asaj kohe. Ne si deputetë në këtë rast kërkojmë që të kontribuojnë të gjitha grupet parlamentare për zhblokimin e KQZ-së. Në këtë rast, ne e dimë që dilema më herët ishte e Presidentit dhe e ka dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Ne e kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Presidenti ka kërkuar që secili grup parlamentar t'i dërgojë emrat në harmonizim në këtë rast edhe me nenin 139, pikën 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, andaj për mendimin tim, kisha bërë thirrje që është mirë secili grup t'i çojë emrat e anëtarëve të tyre për dekretim sipas kërkesës së Presidentit. Pas dekretimit palët e pakënaqura ta dërgojnë çështjen për interpretim në organin kompetent në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë situatë, nëse e kërkojmë fajtorin, sigurisht që opozita mendon që është vetëm një fajtor sepse nuk e marrin detyrën e vet ta kryejnë, sepse e kanë obligim t'i çojnë

emrat, atëherë ne mbetemi në këtë situatë shumë gjatë, sepse duhet t'i dërgojmë emrat edhe opozita, edhe pozita.

Ne si parti jemi në pritje të funksionimit të KQZ-së. U tha edhe nga kolegët paraprakë të Partisë Demokratike se kemi shumë anëtarë, asamblistë që presin të marrin detyrën, sa më shpejt të bëjnë betimin që ta kryejnë punën e vet, ashtu siç i ka mandatuar edhe qytetari i Republikës së Kosovës. Jemi i vetmi subjekt që kemi edhe deputet i cili është në pritje do të thotë për të marrë mandatin, edhe si rezultat apo pasojë e mosfunksionalizimit të KQZ-së, nuk mund ta marrë një gjë të tillë.

Unë kur e them këtë, kemi shumë asamblistë që kanë dhënë kontribut edhe në të kaluarën, pasi kolegia paraprake e tha një asamblist të komunës së vet, unë them që pikërisht nga radhët e Partisë Demokratike e kemi një asamblist që për mandatin e katërt z. Rrok Luli dhe i duhet shumë asamblesë atje në Gjakovë, por kjo për të ndodhur një gjë e tillë, mendoj që opozita nuk është mirë të vajtojë, por është mirë ta kryejë punën e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci, urdhëro!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

U diskutua se Presidenti i vendit duke mos i emëruar anëtarët e KQZ-së po e mban të bllokuar këtë institucion shumë të rëndësishëm për më shumë se një vit tashmë, duke pamundësuar funksionalizimin e tij. Ndonëse aspekti juridik është i qartë dhe se subjektet politike kanë dërguar propozimet e tyre. Të paktën Lëvizja Vetëvendosje u përmend se i ka dërguar dy emrat për të qenë pjesë e KQZ-së sipas të drejtës së tyre kushtetuese, Presidenti qëllimshëm nuk i ka dekretuar ata, duke tentuar të ndërhyjë edhe në përbërjen e KQZ-së.

Përpos se po pamundëson punën e rregullt të KQZ-së, po e shkel Kushtetutën e vendit, po e shpërfill detyrat dhe përgjegjësitë e tij formale dhe juridike, por edhe po pamundëson ushtrimin e detyrave të siç u tha të më së paku dyzet asamblistëve në komuna të ndryshme të Kosovës dhe një deputeti të Kuvendit, duke shkelur kështu edhe të drejtat e njeriut, dhe po ashtu edhe vullnetin e qytetarëve.

Mbajtja e bllokuar e KQZ-së nuk po bëhet rastësisht. Nuk është as neglizhencë, e nuk është as dilemë për përfaqësim. Është thjesht vullneti i Presidentit për të parandaluar çdo mundësi për mbajtjen e zgjedhjeve si dhe për të mos zbatuar ligjin që do mundësonte që në rrethanat në të cilat jemi, opozita të kishte shumicën në KQZ, gjë që garantohet në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të fundit parlamentare. E po ashtu, edhe për të bllokuar shpërndarjen e fondit për subjektet politike. Për më shumë, nuk qëndrojnë as deklarata që u thanë këtu se opozita po e

bllokun KQZ-në, pasi të gjithë anëtarëve, me përjashtim të atij nga Lista Serbe u ka kaluar mandati edhe formalisht nga 15 dhjetori i vitit të kaluar. Vetëm kryetarja e KQZ-së është emëruar dhe me mandat të ri.

Ajo që u vërejt nga deklaratimet e deputetëve, ishte se të gjithë subjektet u deklaruan se janë të interesuar që të ndodhë sa më parë funksionalizimi i këtij institucioni shumë të rëndësishëm. Andaj ne presim që Kuvendi të miratojë rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, LDK-së dhe Alternativës përmes së cilës Presidenti obligohet që në afatin ligjor të emërojë anëtarët e KQZ-së, gjithmonë duke respektuar Kushtetutën e Republikës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese që parasheh përbërjen e KQZ-së në atë mënyrë që tri subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje të kenë përfaqësim të barabartë, e ne jemi të sigurt se duhet të jenë dy anëtarë nga PAN-i, dy anëtarë nga Lëvizja Vetëvendosje dhe dy anëtarë nga LDK-ja.

Duke ditur se Presidenti Thaçi tashmë ka dëshmuar se nuk ka interes primar mbrojtjen e institucioneve të vendit, duke i ditur ndërhyrjet e vazhdueshme të tij për të cilat znj. Haxhiu foli saktë në fjalën e saj, për ndikimet dhe rolin e tij destabilizues në të gjitha pozitat që ka pasur, nuk mund të pritet që nga vullneti i tij i mirë të zgjidhë këtë situatë që vetë e ka krijuar. Andaj edhe ai duhet të pengohet në këtë synim dhe duhet detyruar që të funksionalizohet KQZ-ja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e keni fjalën. A është këtua?

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo çështje e ngritur nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Vetëvendosje është parashtruar për shkak të interesit të përgjithshëm të vendit dhe respektimit të ndarjes së pushtetit në Republikën e Kosovës. Tendencat për t'u personalizuar, apo më mirë them për t'i dhënë kahe selektive, nuk është e drejtë, sepse po flasim për ndërtimin e sistemit politik në vendin tonë. Ne jemi demokraci parlamentare dhe gjithçka çka buron nga e drejta popullore përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të respektohet ashtu siç është e garantuar edhe me aktin më të lartë juridik Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt, Presidenti i vendit me tendencë apo më mirë them duke shfrytëzuar situatën aktuale politike për të interferuar në vullnetin politik të Kuvendit të Kosovës, edhe në vullnetin politik të zgjedhësve të saj, ashtu siç kanë dalë nga zgjedhjet e vitit 2017, është tregues i qartë që bllokimi i KQZ-së është me tendencë dhe është i qëllimshëm.

Pse po e them këtë? E thanë edhe shumica e kolegëve këtu, që e parashtruan mënyrën dhe formën sesi diskutuan, po përgjigjen më të mirë për këtë e ka dhënë edhe vetë përgjigjen ashtu siç është një Gjykatë e lënduar të them kushtetuese, jo me integritet edhe me një moral të fortë e

cila do të kishte një besueshmëri edhe tonën. Por, sido që të jetë, ne jemi të obliguar ta respektojmë dhe ta ruajmë dhe në këtë fazë të cilën gjendemi, ky debat dhe kjo seancë duhet ta përçojë një mesazh, respektimi i vullnetit të zgjedhësve. Zgjedhësit në Republikën e Kosovës kanë votuar për lista, për lista koalicionesh dhe kështu ka buruar edhe mandatet të cilat ne i kemi këtu. Ndërsa sot të tentohet përmes rigrupimeve të reja, apo edhe ndarjeve brenda koalicioneve politike që të ketë ndërhyrje, interferim në kategoritë e tjera kushtetuese dhe në pavarësinë siç është edhe KQZ-ja, është e padrejtë dhe është e patolerueshme në aspektin e ruajtjes së pavarësisë institucionale të gjitha këtyre institucioneve.

Lista PAN, e përbërë nga 22 e sa subjekte politike, e përkthyer në mandate ngërthen në vete edhe Partinë Socialdemokrate të Kaqusha Jasharit. Dhe tash kjo tendenca që të ketë përfaqësues të rinj, për shkak të interesave të reja dhe ndarjeve të reja brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk duhet të lejohet dhe nuk duhet të pranohet. Mbi të gjitha, as të përdoret si shantazh ndaj opozitës për të bllokuar KQZ-në, qoftë për shkuarje në zgjedhje apo qoftë për të marrë mandatin popullor asamblistë dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës. Në këtë aspekt, ne kërkojmë që të respektohet në mënyrë të saktë ndarja, ashti siç kanë dalë nga zgjedhjet e fundit. Jo për dëshirën e Presidentit, as për dëshirën e partive në pushtet, as të subjekteve opozitare, por për shkak të respektit të vullnetit të zgjedhësve të cilët e kanë dhënë me votën e tyre dhe me verdiktin e tyre në zgjedhje të lira dhe demokratike.

Andaj, kjo seancë duhet të shërbejë edhe si thirrje për respektim dhe garantim të mandatit kushtetues çfarë e ka, jo për shantazh, jo për ndërhyrje dhe jo për ndarje selektive. Mbi të gjitha, kjo stërzgjatje e këtij procesi është duke e devaluuar edhe sistemin e brendshëm parlamentar, po mbi të gjitha është ndërhyrje direkt edhe në lirinë dhe pavarësinë edhe të subjekteve politike të cilat funksionojnë përmes fondit të demokratizimit. Mos harroni se ky vendim tash e tre muaj ka lënë qindra familje të cilat e kanë të vetmin burim të të hyrave nga ato të hyra. Punëtorë të ndershëm dhe të cilët presin të bëjnë pagesat e ushqimit për fëmijët e tyre. Ndërsa Presidenti i vendit i shtytur nga interesat e grupeve politike tenton që këtë ta çojë në pafundësi dhe të krijojë situata kur vendi edhe nesër po të krijohet mundësia për të shkuar në zgjedhje, të krijohen bllokada dhe të krijohen paqartësi edhe konfuzion kushtetues. Andaj ne i bëjmë thirrje që ta vërë në funksion mandatin e tij kushtetues, t'i emërojë anëtarët e KQZ-së sipas votës së fundit elektorale dhe të mos krijohen lojëra dhe të mos krijohen situata kur këto mund të përsëriten dhe mund të shfrytëzohen në të ardhmen, qoftë përmes grupeve të tjera, edhe qoftë përmes individëve të tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë,

Presidenti i vendit Hashim Thaçi, i cili nuk është President unifikues e ka bllokuar KQZ-në, sepse dëshiron ta centralizojë ose të centralizojë sa më shumë pushtet rreth vetes, prandaj ai do që në duart e tij të varenë dhe zgjedhjet në Kosovë. Rrjedhimisht zgjedhjet parlamentare që na presin. Ai do ta diktojë jo vetëm dialogun në Kosovë, por edhe zgjedhjet, kohën e mbajtjes së tyre, shantazhin ndaj partive politike në Kosovë.

Mosfunksionimi i KQZ-së i bllokoi edhe mjetet financiare që ndahen për partitë politike, duke e bllokuar qëllimshëm atë. Ai qëllimshëm bllokoi edhe mjetet për subjektet politik. Ai bllokoi qëllimshëm gjithashtu edhe 40 asamblistë e ca deputetë për të marrë detyrën gjithandej nëpër kuvendet komunale dhe këtu në Kuvendin e Kosovës.

Sigurisht, presim dhe kjo është legjitime dhe e drejtë që në fund ky Kuvend, pra Kuvendi i Kosovës të miratojë edhe rezolutën e propozuar nga dy subjektet politike opozitare, nëpërmjet së cilës presidenti obligohet që në afat ligjor të emërojë anëtarët e KQZ-së në atë mënyrë që tri subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje të kenë përfaqësim të barabartë. Pra, dy anëtarë të PAN-it, 2 të Lëvizjes Vetëvendosje dhe dy të LDK-së.

Ne, sigurisht që nuk presim reflektim të presidentit nga vullneti i tij. Ai detyrohet, duhet në fakt të detyrohet nga Kuvendi i Kosovës që ta funksionalizojë KQZ-në dhe jo ta bllokojë atë, sepse kështu bllokohen zgjedhjet dhe vet KQZ-ja. Prandaj, edhe integriteti institucional i KQZ-së.

Në muajin mars është bërë një vit kur KQZ-ja është bllokuar nga Thaçi. Kjo ndërhyrje flagrante në KQZ, është shfaqur si refuzim për ta funksionalizuar e i cili nuk do duhej që të lejohej. Ka një vit të plotë që refuzohet.

Veprimi i tij është antikushtetues. Ai përherë në Kosovë ka qenë bllokues. Ka përçarje subjekte politike, besa edhe ka gjarpëruar përherë në institucionit e vendit të cilat i ka drejtuar edhe po gjarpëron edhe në këtë rast.

Ai e bën skllotë edhe KQZ-në, dhe jo vetëm duke përhapur përçarje te sindikatat në Kosovë, ai do që ta bllokojë edhe Kosovën dhe rruga institucionale të ecë sipas mënyrë së tij. Ndërsa mënyra e ti është jouniteti. Ai është larg i të qenët president i vendit. Ai mund të jetë gjithçka, por më së paku e kryen punën e vet si president.

Duke e bllokuar këtë institucion, po harrohet se bllokohet edhe vendi në përgjithësi.

Kjo çështja e pengut, pra kur KQZ-ja bëhet peng, në shkencat kriminalistike pengu konsiderohet objekt i cili mund të përdoret në funksion të kapësit. Madje, edhe mund të keqpërdoret.

Pengjet nuk janë subjekte të lira. Zakonisht pengjet përdoren. Presidenti e merr peng institucionin, sepse duke e keqpërdorur detyrën e tij, ai e ka humbur qëmoti edhe kredibilitetin e tij si përfaqësues i të gjithë qytetarëve dhe rolin e tij si rol unitar.

Norma dhe fryma që mbartë Kushtetuta e Kosovës, pra ligjet të cilat ekzistojnë në fuqi e detyrojnë atë që të vendosë dhe ta funksionalizojë menjëherë KQZ-në. Tri subjektet politike të cilat duhet të emërohen aty nuk janë peng i Thaçit. Ai nuk mund pra që ta kapë një institucion. Prandaj, Kuvendi duhet ta çlirojë këtë institucion.

Meqenëse s'qenka këtu një deputet me të cilin unë nuk pajtohem për shkak të gjuhës së tij, e cila kaloi në degradim total, shpifës, madje edhe jo etik.

Unë e paralajmërova për hir të parimësisë, sepse nuk jam edhe person i cili kam dëshirë të futem në replika, por megjithatë e përmendi atësinë. Pra, e pati fjalën për atësinë politike. Pra, kolegu nga Nisma kur i drejtohet vetëvendosjes në thirrjen e etërve, pra të babait, nuk duhet ta harrojë asnjëherë atësinë, pra e cila është analoge me vartësinë ndaj PDK-së.

Sepse, ka buruar nga PDK-ja, vartësia, nuk po them ideologjike sepse nuk e di nëse këto dy parti politike kanë ideologji edhe pse njëra thirret në të djathtë e tjetra në të majtë, nuk duhet ta harroj se atësia e deputeti që u thirr këtu me gjuhë tejet të ashpër, mund të konsiderohet edhe si atësi ndaj Hashim Thaçit.

Prandaj, kur thirremi në atësi, nuk duhet të biem pre e gjuhës së denigruar, e cila edhe nuk i takon këtij Kuvendi.

Shumë kohë më parë, në kontekste të ndryshme politike, sidomos pra realizmi socialist, ta kthejmë në shprehje më të thjeshtë në komunizëm, ka pasur atësi edhe ajo atësi ka qenë e lidhur veç në dy forma; në titizëm dhe në komunizëm.

Fal Zotit sot jetojmë në një sistem demokratik të përfaqësuar, të mbipopulluar me parti politike dhe askush nuk ka drejtë që dikujt t'i thotë dhe t'i thirret në atësi. Qoftë ajo edhe atësi politike.

E nëse ka dikush të thirret në atësi, më së paku kanë të drejtë këtë subjektet politike të cilat kanë dalë nga gjiri i subjekteve të mëdha. Prandaj, atësia politike nuk duhet të ekzistojë, madje as si koncept as si term.

Kur thirret, pra duhet të thirret në një gjuhë e cila ka të bëjë me gjuhë tejet demokratike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi ka replikë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Ky kundërshtimi apo le të themi ligjërata e kolegut do të kishte pasur kredibilitet sikur të kishte filluar me kritikë nga nxitësit e asaj replike që ishin nga radhët e tij. Pra, do të kishte pasur kredibilitet vetëm në këtë rast, jo në rastin tjetër.

Tash, rreth atësisë sime. Si duket nëse nuk është propagandë, atëherë ka telashe me historinë edhe timen edhe të atij që ky e konsideron atësi.

Me kryetarin e PDK-së, presidentin e tashëm, më së shumti do të mund të vlenite referenca vëllazëri, sepse kemi qenë në një organizatë politike. Historia ime nuk fillon me PDK, siç fillon e zonjës në fjalë me babën, në kuptimin politik. Pra, me kryetarin tuaj. E ke gabuar edhe kontekstin edhe faktin.

Hashim Thaçi mund të jetë vëllai im politik në një kontekst të caktuar, por assesi babai siç është për juve shoku Albin. Prandaj, po them e ke gabuar totalisht edhe kontekstin edhe argumentin. Atësi nënkupton nga ku ti buron, fillon, dhe ju filloni aty, buroni aty, s'keni të kaluar tjetër.

E kaluara ime është që nga viti 1980, përkatësisht 1981, duke filluar me pjesëmarrjen në ato demonstrata që pardje e patën edhe përvjetorin. Pra, nuk ia ke qëlluar fare. E ke huq totalisht edhe kontekstet edhe faktet.

KRYESUESI: Kundër-replikë! Zotit Rexhaj, fjalën ju lutem.

ARBËR REXHAJ: Sa për huqje të mos flasim, sepse huqjet kanë të bëjnë edhe me kontekstin të cilin po e përmend dhe mos të harrojmë që çdo gjë, pra edhe partitë politike kanë një histori.

Historia Nismës dihet nga ku fillon edhe ku e ka përfundimin. E për huqje të mos flasim.

Unë nuk fola për ty individualisht, unë përmenda një koncept i cili ka të bëjë me këto që i quajmë ne shkenca politike. Nëse ju e etiketoni dikë mbi atësi, atëherë edhe tiketën e atësisë ju e keni përmbi, në mes dhe në këmbët e Hashim Thaçit, dhe jo vetëm ju, por shumë subjekte të tjera politike.

KRYESUESI: Faleminderit për komplimentin! Fjalën e ka zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në fillim po e them që është shumë e qartë që sjellja e presidentit dhe papërgjegjësia dhe shkelja, gjegjësisht mos kryerja e obligimeve të tija kushtetuese është më se e qartë.

Po e rikujtoj atë që e thanë edhe shumë kolegë, që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i pavarur, i përhershëm, kushtetues. Si i tillë, deri më sot pavarësisht vështirësive, sfidave që kanë qenë ashtu siç kanë qenë e ka bërë punën e tij e që fatkeqësisht sot nuk po e bën.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucion të cilin duhet që gjithmonë të bëjmë përpjekje që të gjithë që ai ta kryej ashtu siç duhet funksionin, e kjo varet shumë edhe nga ata që i dërgojmë dhe si i dërgojmë dhe nga veprimi ligjor.

Në vijim të nderuar kolegë, po e përmendi edhe një fakt që, që prej hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me çka është konstituuar edhe KQZ-ja, asnjëherë dhe në asnjë nivel dhe sidomos jo nga ndonjëri prej presidentëve të kaluar, jo ky aktual, nuk është vënë në dyshim se cila duhet të jetë përbërja e këtij organi, duke përfshirë edhe bazën e përfaqësimit.

Kjo për shkak të qartësisë së dispozitave kushtetuese, gjegjësisht Nenit 139 dhe 3 paragrafëve; 2,3 dhe 4, me të cilat përcaktohet përbërja e këtij organi, por me gjasë edhe për shkak të paanshmërisë politike me të cilin i janë qasur presidentët e mëhershëm këtij institucioni.

Prandaj, edhe veprimet e presidentit aktual rreth vonesave për emërimin e përbërjes së KQZ-së pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura më 11 qershor 2017 dhe pas gati 1 viti vonesë, në momenti kur iu drejtua ai Gjykatës Kushtetuese kinse për sqarimin e një gjëje që është e qartë, me të drejtë konsiderohen si ndërmarrje të tij të qarta për qëllime politike sesa për shkak të këtyre paqartësive, gjoja që i ka.

Të nderuar kolegë,

Po jua kujtoj edhe njëherë disave që këtu thanë diçka që nuk qëndron. Përbërja e KQZ-së është 11 anëtarë, duke përfshirë edhe kryetaren, 10 plus kryetarja. 6 janë grupet politike më të mëdha të komunitetit shqiptar dhe 4 janë nga komunitet.

Prandaj, si e pengon opozita funksionin, gjegjësisht krijimin e kësaj trupe kur presidenti mund ta kryej këtë obligim edhe pa neve, në kuptimin e mosrespektimit të asaj që ne e konsiderojmë që është ligjore. Pra, edhe me 5, përkatësisht 6 veta funksionin KQZ-ja.

Prandaj, nuk është topi siç thuhet tek ne, por është tek ai i cili e ka bllokuar këtë institucion të rëndësishëm për ne.

Meqenëse e përmendën dhe nuk dëshiroj që t'i përmend kur kanë përfunduar zgjedhjet nacionale, kur ato lokale dhe sa herë është shtyrë ky afat 60, 90 ditë e tjera e të tjera, më lejoni vetëm të them atë që për mendimin tonë presidentin e bën të papërgjegjshëm është fakti se përtej tejkalimit të të gjitha këtyre afateve ky nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në të drejtimin të përmbushjes së obligimit të tij të qartë kushtetues dhe ligjor deri në ditët e sotme.

Duke vepruar kështu hapur në kundërshtim me nenin 83 dhe sidomos në kundërshtimin me Nenin 84 paragrafin 2 të Kushtetutës sipas të cilit: Presidenti garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjendja e shumë partive politike e në këtë rast po flas për Lidhjen Demokratike të Kosovës, gjendja financiare është e keq për shkak edhe të kësaj bllokade. Për të tjerët nuk e marr të drejtën që të flas.

Po ashtu e përmenden kolegët tanë të respektuar që është një numër po ashtu i madh i njerëzve që vetmin burim ekzistence nga financimi që u bëhet nga partitë politike, të zyrave dhe të punëtorëve të shumtë që i ka secili subjekt, në këtë rast po flas për LDK-në. Derisa po kemi mundësi që t'i rrisim pagat për të tjerët, këta që e kanë burim të vetëm për ekzistencë nuk po mund t'i shfrytëzojnë as ato, sado që i kanë të vogla apo minimale.

Kjo është edhe një shkelje përpos shkeljeve të shumta e të drejtave të njeriut edhe për të realizuar atë që i takon me ligj.

Po ashtu kolegë të nderuar,

Këtu dëgjuam edhe margaritarë të shumtë, besa që themi ne ders, ligjëratë politike. Nuk ua mohojmë edhe atyre që janë, vërtet pa keqkuptim adoleshentë, fillestarë në politikë, që t'i mësojë partitë politike me traditë 30-vjeçare siç është LDK-ja, sesi duhet të sillemi, si duhet të flasim dhe si duhet të veprojmë, sepse është total hipokrizi.

Mos e harroni një gjë; përvojat e partive politike, po edhe të individëve, përvoja nuk zëvendësohet në jetë. Nuk ka zëvendësim për të. Është përvojë, është jeta që i mëson edhe partitë politike, prandaj këto që i kam dëgjuar këto sot, është e habitshme sesi disa marrin guximin që të na tregojnë...Edhe pse ne po mundohemi që t'i kuptojmë edhe evoluimet edhe të subjekteve të caktuara, edhe të individëve, është e drejtë e tyre që të ndryshojnë mendje dhe të shërbejnë tani për atë që e ka pasur dje kauzë të kundërshtimit.

Sidoqoftë, është një e drejtë e tyre të cilën ne nuk po ua mohojmë, sikurse ata po kanë tendencë që ta bëjnë këtë karshi qëndrimeve në këtë rast të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të gjithë atyre që kërkojnë asgjë më tepër vetëm të respektohet ajo që shkruhet e që është në normën dhe në frymën që e sheh parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Nuk po e zgjas së këtu është folur edhe për trimëri se kush po tutet dhe kush nuk po tutet, po ia lëmë opinionit që ta vlerësojë sepse ky vend, Kosova jonë e dashur nuk është aq e madhe që të mos i njohim edhe këto zhvillime po edhe këto evoluime të njerëzve të caktuar për qëllime të caktuara.

Normalisht, kur je në politikë i ke edhe qëllimet e caktuara.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke i marrë për bazë disa nga ato që janë thënë më herët dhe ato që i thashë edhe unë, mendoj që përmbajtja edhe fryma qartësisht e kuptueshme e nenin 139.4 të Kushtetutës së Kosovës, parimet ndërkombëtare mbi të cilat do duhej të ndërtoheshin trupat menaxhuese të zgjedhjeve në rastin tonë KQZ-së, e të cilat i gjejmë edhe te Kodi i Praktikës së mirë në Çështjet Zgjedhore miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij të 52-të plenarë në Venecia më 18 dhe 19 tetor 2002, si dhe praktikën tashmë të ndërtuar në Kosovës dhe rreth të drejtës së përfaqësimit dhe përbërjes së KQZ-së, praktikë e cila asnjëherë nuk është kundërshtuar deri më sot.

Prandaj, kërkojmë nga presidenti i Kosovës, i cili në këtë rast është vënë fatkeqësisht, plotësisht në shërbim të koalicionit qeverisës, që sa më parë të bëjë emërimin e anëtarëve e anëtarëve të KQZ-së në mënyrë që ky institucion t'i kthehet funksioneve të veta ligjore kushtetuese.

Përndryshe, mosfunksionalizimi i këtij institucioni nga ana e tij përbën precedent të rrezikshëm për jetën parlamentare dhe demokracinë në përgjithësi në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për ta përmyllur debatin fjalën e ka propozuesi i çështjes zoti Kurteshi, e pastaj të shohim se a e kemi kuorum e duhur apo duhet ta shtyjmë për mbledhjet e ardhshme.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë faleminderit për diskutimin.

Jam përpjekur që t'i dëgjoj me vëmendje të gjithë. Natyrisht që ka mundësi që ka pasur ndonjë mungesë timen, po i kam dëgjuar të gjithë me kujdes.

Të gjithë ata që i kam dëgjuar asnjë njëri këtu, përveç se ka dhënë ndonjë mendim kuturu, asnjëri asnjë folës nuk ka dalë që ka thënë nuk kërkojmë presidenti që ta funksionalizojë KQZ-në. Unë nuk e dëgjova asnjë.

Mund të ketë domethënë me kundërshtime të ndryshme. Natyrisht, PDK-ja u deklarua hapur se është kundër dhe se nuk do ta votojë këtë rezolutë. Meqenëse s'e kishin tekstin, unë ua ofrova të gjitha grupeve parlamentare tekstin që ta shohin. Teksti ka vetëm një pikë.

Kjo pikë e tekstit thotë: Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që dekretimi i anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të bëhet pa asnjë vonesë: 1. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës; 2. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe 3. Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese nr. KOU, 9/14, të datës 26 gusht 2014.

Kjo është pika e rezolutës. Nuk ka asgjë tjetër.

AAK-ja nuk u deklarua kundër, nuk e ka nënshkruar tekstin e rezolutës, këtu e kam. PSD-ja nuk u deklarua kundër, kishte ato gjuajtjet anash sidomos prej zotit Molliqaj i cili erdhi më vonë dhe nuk i dëgjoi të gjitha diskutimet. Po është çështje e tij. Por, PSD-ja e ka nënshkruar, sepse as nuk u deklaruar kundër.

Nisma as nuk u deklarua kundër as për. Nuk e ka nënshkruar edhe e keqja ishte që doli krejt jashtë temës. Por, zoti Zeka, deputeti Zeka e ka nënshkruar.

Grupi 6+ nuk e ka nënshkruar edhe thonë se; ne nuk mund ta nënshkruajmë pa i pyetur partnerët e koalicionit. Këndeje thirren në grupe parlamentare të pavarura, deputetë me imunitet këndeje thonë nuk mundemi pa e pyetur koalicionin dhe kjo domethënë se nuk je i pavarur nëse është kështu.

Thuhet se ka ndërhyrje në kompetencat e presidentit. Vetëm le të më thotë dikush se cila është ndërhyrja le ta citojë një nen. Zakonisht thonë sipas mendimit tim ose unë mendoj e kështu me radhë. Jo, cila është ndërhyrja në kompetencat e presidentit? Nuk ka asnjë ndërhyrje.

Krejt keni kërkuar nga presidenti që të funksionalizohet KQZ-ja. Për shkak se KQZ-ja është e bllokuar nga vendimi i presidentit. Ky është problemi dhe jo diçka tjetër. Natyrisht, është çështje se a shkon në Gjykatë Kushtetuese apo shkon. Shkon në Gjykatë Kushtetuese. Dikush kundërshton dhe dikush nuk do ta kundërshtojë.

Kishte deputetë që i kanë rënë pikës edhe pse s'janë të opozitës, po e kanë kërkuar pikërisht atë si është ligji dhe nuk ka sesi të mos pajtohemi. Domethënë shtyrjet janë të natyrës politike, nuk janë të natyrës ligjore. Nuk ka asnjë ndërhyrje në kompetencë të askujt. Atë që po e kërkon opozita është respektimi i Kushtetutës, ligjit dhe i vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Kjo do të thotë që brenda pesë ditëve nga dita e marrjes së emrave të kandidatëve që i propozojnë partitë politike, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës duhet të nominohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Askush nuk i ka thënë Presidentit të Republikës së Kosovës se kë dhe si ta nominojë, por vetëm veprimet sipas ligjit. Të kalojnë të gjitha procedurat dhe le të marrë vendim. Le të marrë vendim, le të hapë rrugë për veprime të tjera.

Veprimet tjera ne i kemi të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj dhe këtu nuk ka ndonjë diskutim. Mirëpo, unë fola për sigurinë juridike. Unë këtu dëgjova edhe juristë ose njerëz që interpretojnë Kushtetutën edhe ligjin të cilët nuk kanë lidhje.

Ne e kemi një legjislacion sekondarë që e ruan rendin shoqëror në Republikën e Kosovës. Që e ruan rendin juridik. Mos lexoni vetëm një faqe diku dhe të thoni se po interpretoni. Nëse doni të interpretoni dhe ta dini se çka është rendi shoqëror, siguria juridike ose si mbahet shoqëria, merrni...

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk e kemi kuorumin e duhur për të votuar. E ka përfunduar tash. Hajde zoti Reçica, po e ke kryer diskutimin. E mbylla unë. Sqarim ke? Zoti Reçica ka një sqarim.

ELMI REÇICA: Zoti nënkryetar i Kuvendit,
Po dua një sqarim dhe po thirrem në atë se çfarë diskutoi kolegu paraparak, zoti Kurteshi.

Unë thashë publikisht që nuk e votojmë këtë rezolutë, sepse është ndërhyrje në kompetencat e presidentit.

Ne kemi të drejtë të diskutojmë se ky është Parlament dhe fakti që është Parlament duhet të diskutojmë. Mirëpo, rezolutën unë e kam parë nga parashtrimi i kërkesës më 28 shkurt. Ja ku e kam këtu. Nuk kemi folur për një rezolutë pa e parë, e të cilën duam që të mos e votojmë. Kjo ishte ajo çfarë desha të them.

KRYESUESI: Faleminderit! Hajde zoti Kurteshi. Bilall, a po dëshironi edhe ju? Edhe Bilalli e ka kërkuar fjalën për sqarim. Vazhdojmë pa problem.

SAMI KURTESHI: Unë personalisht kam shkuar tek të gjitha grupet parlamnetare edhe ua kam ofruar tekstin. Unë ia kam ofruar shefit të grupit parlamentar, zotit Krasniqi.

Zoti Krasniqi ka thënë se ne u deklaruam kundër dhe s'e votojmë. Apo jo? Zoti Reçica po thotë se nuk e kam parë tekstin. Cilin tekst? Atëherë e keni gabim. Nuk thash se e ka kundërshtuar pa e parë. Ka deklaruar apriori, ne nuk e votojmë. Nuk thash që e ka parë ose nuk e ka parë. S'kam nevojë, kjo është çështja.

KRYESUESI: Bilall po duan të shkojnë këta, hajt edhe ti... Zoti Sherifi e ka fjalën, edhe ky për interpretim.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Meqë iu referua Nismës, dhe tha se Nisma nuk është deklaruar, e ndjeva si obligim që të deklarohem. Mbajeni në mend kolegë të nderuar, sa herë të kërkonin një dokument të përbashkët, që Parlamenti të vjen me një dokument të përbashkët, duhet së pari të rrini në temë.

Të keni kujdes me gjuhën që e përdorni kundrejt subjekteve për të cilat besoj, meqë kërkoni mbështetje keni nevojë. Dhe kur të jeni korrekt deri në fund do ta keni mbështetjen e Nismës. Përderisa ju shfrytëzoni KQZ-në për ta shndërruar seancën e Kuvendit në seancë ku i shëroni komplekset tuaja, nuk do ta keni mbështetjen e as përkrahjen e Nismës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë e mbyll seancën. Kur të krijohet mundësia për t'u votuar rezoluta, e hedhim në votim. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*